

Analiza e Politikave

Të Mendosh Gjellbër

2 qershor 2009

Kjo analizë e politikave është përgatitur me ndihmën zemërgjerë të Fondit Evropian për Ballkanin

Copyright © IKS, 2009

Të Mendosh Gjelbër

Përmbajtja

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	1
HYRJA.....	3
“MERRNI FRYMË THELLË.....	5
... DHE MOS E PINI UJIN!”.....	10
ATËHERË, ÇDOKUND ËSHTË BETEJË E VËRTETË.....	15
KU GJENDEMI NE?.....	18
NGATËRRIMI I KOMPETENCAVE	26
MJEDISI I KOSOVËS: BRENGË LUKSOZE?	30
KOSOVA E PASTËR: RRUGA PËRPARA	32

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

“Të Mendosh Gjëlber” prezanton gjendjen e mjedisit në Kosovë sot dhe mënyrën si qeveria qendrore dhe qeveritë komunale e trajtojnë këtë çështje, posaçërisht në komunat e Prishtinës dhe Obiliqit. Dokumenti synon të hedh dritë mbi territor të pashkelur më parë, të inkurajoj veprime nga ana e qeverisë, dhe të nxis debat publik mbi çështjet kyçe që ndikojnë në jetën tonë.

Edhe pse Kosova nuk ka monitorim sistematik të ajrit, ujit dhe tokës, informatat e pakta flasin për një gjendje shumë të mjerë. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u), e cila prodhon 98 përqind të rrymës elektrike nga linjiti, hedh rreth 25 tonelata pluhur dhe hi në ajër *çdo orë*, që është 74 herë më e lartë se norma e lejuar me standardet evropiane. Cilësia e dobët e ajrit ndikon në ciklin e jetës dhe ka kontribuar në rritjen e numrit të personave që lëngojnë nga sëmundjet e frymëmarrjes dhe kanceri. Gjendja e ujit është poaq e dyshimtë, dhe shumë qytetarë të Kosovës akoma nuk kanë qasje në ujë të pastër dhe të kontrolluar, dhe rreth 167,000 tonelata të ujërave të zeza të patrajuara derdhen drejtpërsëdrejti në lumenjtë e Kosovës *çdo vit*. Të gjithë ata që brengosen për ta shikuar gjendjen prej së afërmi do të shohin se shkatërrimi mjedisor ka shtrirje shokante, dhe pastrimi i mjedisit nuk është detyrë e lehtë për një qeveri me vullnet jo shumë të shprehur.

Zhvillimi industrial ende shihet si shenjë e progresit, derisa mjedisi konsiderohet brengë luksoze të cilën një vend në zhvillim e sipër thjeshtë nuk mund t’ja lejoj vetës. Përqendrimi i politikës aktuale mjedisore në Kosovë deri më sot duket të jetë drejt përmbushjes së standardeve për anëtarësim në BE, sesa një përkushtim i mirëfilltë nga ana e qeverisë për mbrojtje të mjedisit. Vendet kandidatë duhet t’i harmonizojnë sistemet e tyre ligjore me legjislacionin e BE-së, dhe mbrojtja e mjedisit është në mesin e fushave më të ndërlikuara të politikave në këtë proces.

Në një proces me hap të shpejtë dhe gjysmë-neglizhent, Qeveria e Kosovës ka shpejtuar në hartimin e disa ligjeve që lidhen me mjedisin në Kosovë. Prosesi në përgjithësi ka qenë i nxituar dhe nuk i është kushtuar vëmendje adekuate sigurimit të legjislacionit sekondar i cili është i nevojshëm për zbatimin e këtyre ligjeve. E gjithë kjo e shoqëruar me mungesë të përkushtimit financiar nga ana e qeverisë, me staf jokompetent, me bashkëpunim të dobët ndërministror, me ngatërrim të kompetencave dhe me vetëdijësim minimal publik, tregon që mbetet akomë shumë për t’u bërë në fushën e zbatimit.

Ndoshta gjendja e mjerë nuk mund të ndryshohet brenda natës, por hapa të qartë mund të mirren. Së pari, qeveria duhet të tregoj më tepër përkushtim ndaj çështjeve të mjedisit. Kjo duhet të përfshij më tepër alokime të mjaftueshme buxhetore, rekrutimin e ekspertëve, qartësimin e përgjegjësive, miratimin e legjislacionit sekondar, përmirësimin e sistemeve për monitorimin e ndotjes, dhe zbatimin aktiv të legjislacionit ekzistues. Por

për momentin, ne së paku mund t’i bëjmë thirrje qeverisë të dal me një hartë rrugore për dy çështje emergjente: *të drejtën për ajër të pastër dhe të drejtën për ujë të pastër.*

Qytetarët poashtu kanë rol të rëndësishëm në pastrimin e Kosovës dhe pastaj ta mbajnë atë të pastër duke shndërruar hedhjen e mbeturinave në praktikë të turpshme shoqërore dhe duke i raportuar rastet e shkeljes së legjislacionit aktual. A duhet të qëndrojmë anash në mënyrë pasive dhe të heshtim derisa njerëzit rreth nesh vdesin nga kanceri, derisa fëmijët pijnë ujë të ndotur në shkolla, derisa fenolet e helmueshme dëpërtojnë thellë në ujin dhe tokën tonë duke e kontaminuar ushqimin tonë, dhe derisa sëmundjet e kanaleve të frymëmarrjes përhapen rreth nesh?

Siç do të tregoj ky raport, ka shumë arsye, në mesin e të cilëve është edhe shëndeti ynë, për t’i trajtuar problemet mjedisore *tash*, para fillimit të negociatave për anëtarësim në BE. Nëse presim gjendja do të përkeqësohet dhe do të jetë gjithnjë e vështirë t’i adresojmë problemet. Të gjitha sferat e shoqërisë sonë duhet të tregojnë gatishmëri për ta trajtuar këtë çështje dhe për t’u angazhuar. Duhet të ketë përkushtim më të madh ndaj “Të Mendosh Gjellbër.”

HYRJE

“Të mendosh gjelbër” prezanton një pamje të gjendjes mjedisore në Kosovë sot dhe mënyrën se si qeveria qendrore dhe qeveritë komunale e trajtojnë këtë gjendje, posaçërisht në komunat e Prishtinës dhe Obiliqit. Ky dokument synon të shërbej si shembull për të tjerët në Kosovë që ta krahasojnë, mësojnë dhe të kontribuojnë. Kemi bërë orvatje të identifikojmë se çka ekziston në letër dhe se çka po bëhet konkretisht në terren. E zgjodhëm Prishtinën si njerin prej rasteve studimore sepse ajo është konglomerati më i madh urban në Kosovë, dhe vendbanimi afërsisht i një të shtatës së popullsisë së vendit tonë. Jashtë kufijve të qytetit të Prishtinës shtrihet komuna rurale e Obiliqit me madhësi të konsiderueshme dhe ky është subjekti i rastit tonë të dytë studimor. Edhe nga Prishtina mund të shihet se Obiliqi është njëra prej katastrofave më të mëdha mjedisore në Kosovë. Derisa termocentralet vazhdimisht zbrazin hi, brigjet përreth Obiliqit janë të shkretuara nga mihja e vazhdueshme e qymyrit. Çfarë reçete ofron shteti për zgjidhjen e problemeve mjedisore në këto komuna?

Në mes të hulumtimit tonë, vendosëm të përqendrohemi në dy çështje madhore: ujin dhe ajrin. Natyrisht ka shumë çka tjetër të thuhet për shembull për konsumimin e brigjeve, parqeve dhe zonave të gjelbra të Prishtinës nga ndërtimet e pakontrolluara; për kontaminimin e tokës nga pesticidet jo të rregullta dhe substancat e tjera toksike; për ndotjen e ujërave nëntokësorë; për mbrojtjen e cilësisë së ushqimit, për shpyllëzimet, rrëshqitjet e dheut, mbipeshkimin, shfrytëzimin e parregullt të lumenjve dhe brigjeve, dhe një listë të gjatë të çështjeve tjera që sigurisht e dëmtojnë mjedisin në Kosovë. Derisa të gjitha këto çështje e ngacmojnë kureshtjen tonë, mjerësisht kemi gjetur tejet pak ose fare hiq dëshmi shkencore, civile apo qeveritare mbi të cilat do të mund ta mbështesnim diskutimin tonë. Është më se e qartë që nevojiten më tepër kërkime dhe hulumtime në këtë drejtim. Megjithatë, shpresojmë që kemi përshkruar në mënyrë të qartë dhe të hollësishme funksionimin dhe dështimet e ndërlydhura me këto dy çështje në atë masë sa lexuesit nuk do t’i pengoj ky shkurtim.

Gjendja mjedisore në Kosovë, siç përshkruhet në këtë dokument, nuk duhet të jetë befasese dhe shokuese për askend. Shenjat e qarta të keqësimit të gjendjes mjedisore ekzistojnë më tepër se 15 vite. Në vitin 1992, një raport i hartuar nga grupi Suedez për Hulumtim të Ambientit dhe Zyrës Rajonale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë paralajmëronte se, “gjendja mjedisore është kritike. [P]roblemet e mëdha me hedhjen e mbeturinave dhe ndotja e ajrit dhe e ujit me dioksid të sulfurit [dhe] metale të rënda, ka rezultuar me degradim serioz të gjendjes mjedisore dhe ka ndikim të ndjeshëm në shëndetin e popullatës lokale, duke e bërë Kosovën njërin prej vendeve më të ndotura në Evropë.”¹

¹ Luan Shllaku & Lars Lannöner; *Ambineti në Kosovë*; Grupi Suedez për Hulumtim të Ambientit dhe OBSH. Stockholm, 1992.

Megjithatë, ka shumë pak kërkime, dokumente dhe informata (të disponueshme) mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë. Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit në Kosovë 2006-2007 përmban me gjasë informatat më koherente dhe të hollësishme, por nuk ka arritur ta tërheq vëmendjen e publikut të gjerë.² Shtypi ditor vetëm herë pas here i trajton çështjet mjedisore, dhe deri më sot nuk ekziston asnjë botim i hollësishëm apo shpjegues mbi këtë çështje. Asnjëherë nuk ka pasur tema aq të “nxehta” apo urgjente për ta mobilizuar publikun për veprim apo protestë të përbashkët. Natyrisht, ndotja e padukshme që mbretëron në ajrin dhe ujin tonë është pothuajse e panjohur për shumicën e qytetarëve.

Si rrjedhojë, në Kosovë nuk ka pothuajse fare mbrojtje mjedisore. Organizatat ndërkombëtare mjedisore si Greenpeace, Nature Conservancy, apo World Wildlife Fund nuk kanë zyre në Kosovë. Shtetet tjera evropiane dhe vendet që së shpejti do të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian po ndjekin një qasje të integruar e cila merr parasysh mjedisin njerëzor (siç janë mbeturinat, mbeturinat në ujë, ajrin, ushqimin) si dhe mjedisin natyror (mbrojtjen e natyrës dhe specieve, zonimin, prodhimin e energjisë alternative). Por duket se në nivelin politik, social apo edhe ndërkombëtar të Kosovës nuk ekziston një shkallë e tillë e vetëdijesimit. Shoqëria kosovare ende merret me rezultatet e industrializimit dhe urbanizimit të rrezikshëm si dhe me ndryshimet vështirë të pranueshme të tranzicionit drejt ekonomisë të tregut.

Së paku, uji i pijshëm, mbledhja e bashkërenduar e mbeturinave, zgjerimi i zonave të gjelbra, dhe kontrolli mbi cilësinë e ajrit duhet të jenë tema dominuese të ditës. Por shumë pak ekonomi familjare tregojnë vullnetin për mbulimin e shpenzimeve të ndotjes së tyre. Me mijëra deponi private të egra të mbeturinave janë të shpërndara në brigje në mbarë Kosovën si dhe janë të vendosura thellë në lumenjtë e vendit. Disa sektorë të caktuar të shoqërisë e shfrytëzojnë paqartësinë ligjore dhe dobësinë e shtetit për ta shkatërruar në mënyrë të vazhdueshme tokën bujqësore, për t’i shpërdorur pyjet, për ta kontaminuar tokën, për t’i shpërdorur burimet ujore, për t’i përdorur teknikat e vjetruara të prodhimit, për mbipeshkim, dhe për zgjerimin e zonave industriale dhe atyre të banimit. Të gjithë ata që dëshirojnë për ta shikuar gjendjen prej së afërmi do të shohin se shkatërrimi mjedisor ka shtrirje gjithandej. Me pak fjalë, kjo nuk është detyrë e lehtë për një qeveri me vullnet jo shumë të shprehur.

Kjo analizë e politikave e prek vetëm majen e akullnajës. Analiza synon të jetë kontributi i parë për një diskurs publik i cili është pothuajse inekzistent. Shpresojmë që ky dokument do të hedh pak dritë mbi një terren të pashkelur më parë, se do të inkurajoj veprim nga ana e qeverisë, dhe se do të nxit debat publik mbi çështjet kyçe që ndikojnë në jetën tonë.

²Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007, Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë, AKMM, 2008.

Me kapitullin “Merrni frymë thellë ... dhe mos e pini ujin!,” punimi nis diskutimin mbi gjendjen e ujit dhe ajrit në Kosovë dhe ndikimin e tyre serioz në shëndetin e kosovarëve. Analiza pastaj ekzaminon historinë e gjatë pan-evropiane të betejës për mbrojtje të mjedisit dhe hapat të cilat duhet t’i ndërmerret Kosova për t’iu bashkuar fqinjëve të saj në veri dhe përpjekjeve të tyre drejt një Evrope “më të gjelbër.” Kapitujt “Ku gjendemi ne?” dhe “Ngatërimi i Kompetencave” trajtojnë së afërmi legjislacionin aktual për mjedisin në Kosovë dhe zbatimin e politikave në praktikë. “Mjedisi i Kosovës: Brengë Luksoze?” trajton disa sfida tjera me të cilat ballafaqohet qeveria në rrugën drejt përmirësimit të gjendjes së mjedisit. Në fund, “Kosova e Pastër: Rruga Përpara” përmban rekomandime praktike për qeverinë dhe qytetarët drejt Kosovës “më të gjelbër.”

“MERRNI FRYMË THELLË ...

Edhe pse në Kosovë mungon monitorimi sistematik i ajrit, ujit dhe tokës, informatat e pakta për mjedisin tregojnë gjendje shumë të mjerueshme. Për ta parë degradimin mjedisor i cili po e pllakos Kosovën, nuk duhet të udhëtoni më larg se kryeqyteti i Prishtinës. Vizitorët ndërkombëtarë, qytetin me rreth 300,000³ banorë, rreth 1/7 e popullsisë së përgjithshme të Kosovës, e quajnë me emrin “Prish-stinky” (në përkthim të lirë qyteti kutërbues) për shkak të ajrit tejet të ndotur. Njëri prej shkaktarëve të ndotjes së ajrit në Prishtinë është trafiku përplotë me dizel në rrugët e stërngarkuara të qytetit. Pastaj janë edhe sistemet e ngrohjes më qymyr dhe me dru dhe ndërmarrja e ngrohjes qendrore “Termokos” që është njëkohësisht edhe ndotësi më i madh në brendi të qytetit.

Por burimi kryesor i cilësisë së dobët të ajrit në Kosovë dallohet lehtë: mihja e qymyrit dhe prodhimi i energjisë elektrike nga ofruesi i vetëm i energjisë elektrike në Kosovë, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).⁴ Kosova është shteti i VETËM në Evropë që prodhon 98 përqind të energjisë së saj elektrike nga linjiti.⁵ Përdorimi i qymyrit për prodhimin e energjisë elektrike, e cili daton që nga vitet e 1920-ta, ka vazhduar me vite të tëra pa konsideratë për pasojat mjedisore. Për më tepër, cilësia e linjtit në Kosovë është e njohur ndërkombëtarisht për përqendrimin e lartë të hirit.⁶

Gjatë dimrit, niveli i hirit dhe smogut i kalon për shumë herë standardet ndërkombëtare të ndotjes së ajrit.⁷ Matjet e fundit të ajrit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) në Kosovë janë alarmante: vetëm në dy pika të matjes në Prishtinë, niveli i materies së imët në ajër dhe e Oksidit të Nitrogjenit (NO₂) gjatë vetëm tre muajve të matjes i kanë

³ IKS Punim Diskutimi: Vizionet Utopike, Prishtinë, 2006.

⁴ Koorporata momentalisht përfshin dy mihje të hapura, minierat në Mirash dhe Bardh; dy termocentrale, “Kosova A” dhe “Kosova B” si dhe 51,969 km rrjet distribus që mbulon tërë Kosovën.

⁵ AKMM, Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor *Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007*, Prishtina, 2008.

⁶ Forumi 2015, *Një Përall Moderne*, Prishtinë, 2007, pg. 32.

⁷ Intervistë e IKS me Sylë Tahirsylaj, Drejtor i Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës, Prishtinë, Nëntor 2008.

kaluar emetimet e lejuara për 18 herë.⁸ Kjo nuk është shumë befasuese pasi që matjet e mëhershme në vitin 2005 tregonin që emetimi i grimcave fluturuese të hirit nga Termocentrali Kosova B i kalonin standardet e BE-së për katër deri në pesë herë.⁹

Kur termocentralet e KEK-ut punojnë me kapacitet të plotë, njësitë prej 200 MW emetojnë afërsisht 25 tonelata pluhur dhe hi *në orë*, që është 74 herë më e lartë se norma e lejuar me standardet evropiane. Këto emetime përmbajnë CO₂, SO₂, dhe NO₂.¹⁰ KEK-u nuk i ka botuar nivelet e sakta të emetimit dhe prandaj ato edhe sot e kësaj dite mbesin të panjohura për publikun, por të dhënat nga viti 1994 tregojnë që termocentralet kanë hedhur 70,000 tonelata hi në ajër çdo vit, me mesatare prej rreth 200 tonelata në ditë.¹¹ Të dhënat e përgatitura në vitin 2002 tregojnë që KEK-u kishte emetuar më tepër se 4.4 milion tonelata CO₂ në vit, apo rreth 510 tonelata *në orë*. Të gjitha së bashku, ekonomitë familjare në Kosovë kanë prodhuar vetëm 38,466 tonelata.¹² Është e tepërt të thuhet që termocentralet dhe mihjet sipërfaqësore të linjtit janë ndotësit më të mëdhenj të ajrit në vend.¹³

Për më tepër, rreth 50 milion tonelata të hirit thjeshtë qëndrojnë rreth termocentralit të pambuluara.¹⁴ 30,000 banorët e komunës së Obiliqit jetojnë në 15 fshatra që gjenden rreth termocentraleve. 10 kilometra larg Prishtinës, Obiliqi konsiderohet njëri ndër vendet më të ndotura në Kosovë. Deponitë e hirit, të mbushura tash e 40 vite të japin përshtypjen e rrejtshme të brigjeve natyrore. Por për shkak të masave të pamjaftueshme mbrojtëse, hiri tash është bërë burim i përhershëm i ndotjes së ajrit, posaçërisht kur fryejnë erërat.

Rishtazi, IKSHP ka lëshuar një paralajmërim publik për cilësinë gjithnjë e më të keqe të ajrit në Kosovë. Pluhuri nga emetimet e CO₂, SO₂, dhe NO₂ i kontribuojnë rrezikut të lartë të sëmundjeve të traktit të epërm dhe të poshtëm të frymëmarrjes, përfshirë këtu infeksionet dhe alergjitë.¹⁵ Cilësia e dobët e ajrit në mënyrë të drejtpërdrejt po ndikon në ciklin e jetës dhe në shëndetin e përgjithshëm të popullatës. Derisa të gjithë janë të ndikuar nga kjo, ndjeshmëria varet nga shëndeti apo moshë.¹⁶ IKSHP ka vërejtur numër të rritur të fëmijëve me probleme të traktit të epërm të frymëmarrjes, siç janë astma dhe alergjitë, si rezultat i drejtpërdrejt i ajrit të ndotur. Instituti poashtu ka identifikuar rritje

⁸ Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, *Raporti i Ajër-ndotjes*, Prishtinë, Janar-Mars 2009.

⁹ L.Zeneli, N.M. Daci, M.N. Daci-Ajvazi, H. Pacarizi, *Effects of pollution on lead and cadmium concentration and correlation with biochemical parameters in blood of human population nearby Kosovo thermo power plants*, Zhurnali Amerikan per Biokimi dhe Bioteknologji, 2008, f. 273.

¹⁰ Ferdezi Bekteshi, "Challenges Facing Kosova," Prishtinë, REC, 2008.

¹¹ Forumi 2015, *Një Përall Moderne*, Prishtinë, 2007, pg. 35.

¹² UNMIK-PISG Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë, *Kosovë – Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, Prishtinë, Prill 2003.

¹³ L.Zeneli, N.M. Daci, M.N. Daci-Ajvazi, H. Pacarizi, *Effects of pollution on lead and cadmium concentration and correlation with biochemical parameters in blood of human population nearby Kosovo thermo power plants*, Zhurnali Amerikan per Biokimi dhe Bioteknologji, 2008, f. 274.

¹⁴ MMPH, Prezentim në Gratz, "Ndotja e Ajrit," Nezakete Hakaj, 2007.

¹⁵ Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik *Raporti i Ajër-ndotjes*, Prishtinë, Janar-Mars 2009.

¹⁶ Strategjia Evropiane për Ambient dhe Shendet: Faktet dhe Numrat, 2008.

prej 20 përqind të numrit të fëmijëve me anemi në 10 vitet e fundit.¹⁷ Drejtori i Institutit, Naser Ramadani, pohon që këto sëmundje janë rezultat i gjendjes së keqe të mjedisit.

Banorët e Obiliqit e kanë përjetuar në mënyrë të drejtpërdrejt ndikimin e ajrit të ndotur. Gezime Shala, banore e fshatit Hade në Obiliq, është nënë 27-vjeçare e dy fëmijëve, dhe ka kaluar të jetoj në këtë fshat kur u martua para pesë viteve:

Herën e parë kur erdha këtu nuk mund të merrja frymë dhe sytë më kruheshin tërë kohën. Më vinte për të vjellë dhe sëmuresha rëndë tërë kohën. Tash fëmijët e mi sëmurën tërë kohën, por nuk kam të holla t'i dërgoj te mjeku. Burri im fiton vetëm 80 euro në muaj, punon në shkollë, por këto para nuk mjaftojnë për një familje me gjashtë anëtarë. Shpresoj se një ditë do të mund të largohemi prej këtu. Që dy vite na kanë premtuar një apartament të vogël në Obiliq, por i tërë procesi është shumë i ndërlikuar.¹⁸

Vërtet, komuna e Obiliqit ka raportuar incidencën më të lartë të Infektiveve të Traktit të Poshtëm të Frymëmarrjes: 449.6 raste në 100,000 banorë në javë.¹⁹ Kjo me gjasë është e lidhur me ndotjen e ajrit nga termocentralet.

Punëtorët në Obiliq janë në mesin e personave që ndikohen më së tepërmi nga kjo gjendje. Gjatë punës së tij 29-vjeçare si mjek dhe Drejtor i Institutit për Shëndetin në Punë, z. Xhevat Pllana ka vërejtur se problemet më të shpeshta shëndetësore në mesin e punëtorëve kanë qenë sëmundjet e traktit të epërm respirativ. Rreth 30 përqind e të gjithë punëtorëve kanë probleme kronike respirative, mirëpo në mesin e tyre kanë edhe probleme kardiovaskulare. Sipas Institutit për Shëndetin në Punë, punëtorët të cilët nuk jetojnë në zonën e KEK-ut janë shumë më të shëndetshëm se kolegët e tyre që jetojnë në rrethinë.²⁰

Megjithë, këto statistika bazohen vetëm në rastet e raportuara. Njerëzit siç është Gëzimja nuk mund të shkojnë rregullisht te mjeku për shkak të gjendjes së dobët financiare dhe prandaj ata nuk pasqyrohen në raporte. Një studim i botuar nga American Journal of Biochemistry and Biotechnology, i cili bëri analizën e mostrave të gjakut të njerëzve që jetojnë afër termocentraleve poashtu tregoi një rritje alarmante të përqendrimit të hekurit dhe kadmiumit që mund të shkaktojnë dëmtime në tru, sëmundje të zemrës dhe mutacione.²¹

¹⁷ Intervistë e IKS me Naser Ramadani, Drejtor i IKSH, Prishtinë Prill 2009.

¹⁸ Intervistë e IKS me Gezime Shala, Obiliq, Dhjetor 2008.

¹⁹ Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit 2004*, Prishtinë.

²⁰ Intervistë e IKS me Xhevat Pllanen, Drejtor i Institutit për Shëndetin në Punë, Obiliq, Nentor, 2008.

²¹ L. Zeneli, N.M. Daci, M.N. Daci-Ajvazi, H. Pacarizi, *Effects of pollution on lead and cadmium concentration and correlation with biochemical parameters in blood of human population nearby Kosovo thermo power plants*, Zhurnali Amerikan për Biokimi dhe Bioteknologji, 2008, f. 273.

Termocentralet në fakt kanë ndikim të dyfishtë negativ në kushtet jetësore në fshatrat e Obiliqit sepse ato i ndotin në mënyrë të ndjeshme edhe lumenjtë. Lumi i afërt Sitnica është i “vdekur” si rezultat i ujit të patrajtuar industrial që derdhet nga termocentralet në shtratin e tij. Studimet e bëra në vitin 1989 tregonin që ujërat poshtë termocentraleve Kosova A dhe Kosova B nuk përmbajnë sasi të mjaftueshme të oksigjenit për të ruajtur çfarëdo forme të jetës.²² Shumë më të dëmshme se hiri i Obiliqit janë substancat kimike siç janë përzierjet helmuese acidike që burojnë nga qymyri të quajtura fenole. Gjatë stinëve të shirave, këto kemikalie treten në ujë dhe depërtojnë në tokë. Si rezultat, uji dhe toka e ndotur janë helmuese për njerëzit dhe mund të veprojnë si kancerogjen.²³

Ndotja e ujit ka kontribuar në krijimin e kushteve brengosëse të shëndetit në mesin e banorëve të Obiliqit, përfshirë këtu 255.12 raste të raportuara të diarresë akute për 100,000 banorë në javë. Simptomët e tyre dëshmojnë për probleme me ujin e pijshëm dhe pastërtinë me gjasë të shkaktuara nga ndotja sekondare nga termocentralet dhe trajtimi i pamjaftueshëm i ujit nga ofruesit e shërbimeve publike.²⁴

Sidoqoftë, diarrea duket të jetë problemi i tyrë më i vogël. Termocentralet kanë ndikuar edhe në tokën bujqësore. Përveç minierave gjigante të hapura të qymyrit, maleve të mëdha të hirit që i ngjasojnë planetit Mars, dhe vet termocentraleve, së paku 1,559 hektarë të tokës së dikurshme bujqësore në Obiliq sot janë të papërdorshme.²⁵ Edhe pse nuk ka informata të mjaftueshme për publikun, ndotja e ajrit me gjasë po e helmon ushqimin dhe po i kontribuon përhapjes së sëmundjes së kancerit.

Jonuz Grajqevci, një banor tjetër lokal, punon në termocentral që 30 vite. Ai poashtu është kopshtar i apasionuar. Mirëpo, me kalimin e kohës ai është bërë dëshmitar i shkatërrimit të kopshtit të tij në fshatin Hade, njërin prej vendeve të para të mihjes së qymyrit në Kosovë:

Unë vij shpesh këtu dhe punoj në kopshtin tim. Natyrisht, pemët nga Hadeja nuk mund të hahen. Çdo verë duhet të hedh sasi të madhe të dredhëzave. Kjo është shumë keq, vërtetë. Unë gjej kënaqësi të madhe në kopshtari... më është dashur ti pres [50 pemët që i kam mbjellur para 10 viteve] dhe të mbjell pemë të reja. As drunjtë nuk mund ti qëndrojnë gazrave në ajër që emetohen nga dy termocentralet.²⁶

Kopshtet lokale nuk janë të vetmet që janë ndikuar nga termocentralet. Ai shpjegon që kjo ka pasojë të mëdha në jetën e njerëzve:

²² E. Beqiri et al., *Mathematical model for self-purification capacity of Sitnica river*. Presentuar në Konferencën e 7⁴⁶ Internacionale të Kimisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Poloni 1989; cituar në *Një Përall Moderne*.

²³ Forumi 2015, *Një Përall Moderne*, Prishtinë, 2007, f. 38.

²⁴ Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit 2004*, Prishtinë, f. 56.

²⁵ Forumi 2015, *Një Përall Moderne*, Prishtinë, 2007, pg. 40.

²⁶ Intervistë e IKS me Jonuz Grajqevci, Obiliq, Nëntor 2008.

Kur të gjithë rreth jush vdesin nga kanceri, ju vetëdijësoheni për vendin ku jetoni. Vëllau im është i sëmurë nga kanceri, ai jeton mu afër shtëpisë sime. Nëna ime vdiq nga kanceri para disa vitesh. Axha im dhe mbesa ime 30 vjeçe poashtu janë të sëmurë nga kanceri. Ata të gjithë jetojnë këtu, në fshatrat e Obiliqit.

Hajdar Shala jeton në afërsi në një shtëpi të madhe me katër djemtë e tij të papunë. Ata shpresojnë që ky do të jetë dimri i fundit që do ta kalojnë në fshatin ku ishin lindur gjyshërit e tij të ndjerë:

Gruaja ime vdiq para disa vitesh. Shëndeti i saj ishte tejet i ligë për këtë vend. Ajo sëmurëj tërë kohën. Vëllau im është i sëmurë; po vdes nga kanceri. Mjekët na kanë thënë që ai duhet të largohet prej këtu menjëherë... që ajri në këtë vend është si të thithësh helm. Gruaja e vëllaut tim është e sëmurë dhe mjekët këtu nuk e dinë saktësisht çfarë sëmundje ka. KEK-u tash ka hapur një kanal që kalon rreth shtëpisë sime, i cili e mbledh ujin nga minierat, kështu që shtëpia ime mund të fundoset në fenol. Nuk më ka mbetur asnjë copë e tokës bujqësorë për ta punuar.²⁷

Ruzhdi Mirena, përfaqësues i fshatit të Hadesë, nuk posedon statistika zyrtare, por ai e shpjegon përhapjen e kancerit dhe sëmundjeve në fshatin e tij të vogël me 160 shtëpi. Duke ndenjtur nën qiellin e zi të mbushur me tym, ai thjesht e drejton gishtin në çdo shtëpi, “në atë shtëpi, të gjithë janë të sëmurë. Dhe në shtëpinë afër saj, një 32-vjeçar vdiq nga kanceri vitin e kaluar. Njerëzit [këtu] janë të sëmurë, të varfër dhe të dëshpëruar.”²⁸

Dardhishtja është një tjetër “fshat i kancerit” afër termocentraleve të KEK-ut, ku shumë njerëz lëngojnë nga kanceri dhe pothuajse të gjithë vazhdimisht kanë simptome të gripit.²⁹ Igballe Bllaca e përshkruan gjendjen në fshat:

Nëse i varr teshat për tu terur jashtë, ato do të jenë më të ndotura se para larjes. Unë kam shtypje të lartë të gjakut, vuaj nga një sëmundje e zemrës, dhe akoma nuk jam 40 vjeçare. Mjeku më tha që të gjitha janë pasojë e ajrit të ndotur në Dardhishte. Djali im 7 vjeçar vuan nga astma, dhe dy vajzat e mija tërë kohën kanë simptome të ftohjes dhe gripit. Por megjithatë, e konsideroj veten fatlume në krahasim me fqinjët e mi të cilët vuajnë nga kanceri. Dy shtëpi më larg prej këtu, para dy javësh një 35 vjeçar vdiq nga kanceri. Është vërtetë tmerruese kur i sheh të gjithë njerëzit përreth teje të sëmurë dhe krejt kjo për shkak të ajrit që e thithim. Fatkeqësisht, nuk mund të bëjë asgjë. Nuk kam para për t’u larguar prej këtu.³⁰

²⁷ Intervistë e IKS me Hajdar Shala, Obiliq, Dhjetor 2008.

²⁸ Intervistë e IKS me Ruzhdi Mirena, Obiliq, Dhjetor 2008.

²⁹ Intervistë e IKS me Igballe Bllaca, Obiliq, Dhjetor 2008.

³⁰ *Ibid.*

Është e qartë që të varfërit siç janë Igballja, Hajdari, Gëzimja, dhe fëmijët e tyre janë më së tepërmi të ndikuar nga kjo katastrofë mjedisore, sepse çdokush me pak mundësi financiare do të ishte larguar nga ky vend menjëherë.

... DHE MOS E PINI UJIN!”

Çuditërisht, bisedat në kafenetë e Prishtinës përplot me tym, tregojnë që qytetarët nuk i frikësohen rrezikut iminent nga termocentralet e Obiliqit, përkundër të gjitha rasteve të kancerit atje. Përveç ajrit bezdisës me pluhur, ata besojnë që janë të sigurt nga çdo rrezik. Ndoshta është normale që banorët e qendrave urbane t’i injorojnë problemet jashtë kufijve të qytetit të tyre. Sidoqoftë, prishtinalitë nuk mund t’i injorojnë faktet evidente vijuese për atë që rrjedh në gypat e tyre të ujit dhe se ku zhduken në mënyrë magjike jashtëqitjet e tyre pasi që të hedhen në toalet.

Kosova është vend që nuk ka dalje në det dhe nuk ka liqenj të mëdhenj natyror. Për ta tejkaluar këtë disavantazh, socialistët në vitet e 70-ta dhe 80-ta udhëhoqën ndërtimin e rezervave të mëdha artificiale të ujit në mbarë vendin. Liqeni i Radoniqit u ndërtua për t’i përmbushur nevojat në rritje të komunave të Gjakovës, Rahovecit dhe Prizrenit, dhe Liqeni i Gazivodës në Zubin Potok për furnizimin e Mitrovicës. Për qytetin e Prishtinës u ndërtuan liqenjtë e Badovcit dhe Batllavës. Një projekt gjigant ujqorë u dizajnuar dhe u ndërtua *fillimisht* për ta lidhur lumin e Lepencit në jug, i cili rrjedhte në lumin maqedonas të Vardarit dhe pastaj derdhej në Detin Egje, me lumin Ibër në veri, i cili rrjedhte në veri drejt bazenit të Danubit dhe derdhej në fund në Detin e Zi. Ambiciet ishin për t’i furnizuar vazhdimisht fushat e Kosovës, të njohura shekuj me radhë për bujqësinë e tyre të çmueshme, me ujë të pastër dhe për ta zgjedhur një kohësisht problemin e furnizimit me ujë të numrit të madh të banorëve në viset rurale. Mirëpo, projekti Ibër-Lepenc kurrë nuk u finalizua, dhe sot përpunimi bujqësor në Kosovë është vetëm hije e gjendjes së viteve të 80-ta.³¹

Mungesa e burimeve natyrore të ujit mbetet problem madhor në Kosovë. Mungesa e ujit të pastër dhe të pijshëm është edhe më serioze. Statistikat e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) tregojnë që 73 përqind e popullatës ka qasje në sistemet publike të furnizimit me ujë (27 përqind mbesin akoma të palidhur).³² Në anën tjetër, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik posedon statistika tërësisht të ndryshme nga këto. Instituti pohon që vetëm 57 përqind e popullatës është e lidhur me sistemet publike të furnizimit me ujë (43 përqind mbesin të palidhur me çfarëdo sistem të furnizimit të organizuar me ujë).³³ Të dyja burimet megjithatë pajtohen që mbi një e treta e popullatës

³¹ Bibloteka e Resurseve të IKS, Prishtinë 2004-2009.

³² Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007, Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, AKMM, 2008, f. 56.

³³ Prezentim i Prof. Dr. Selvete Krasniqi, *Cilësia e Ujit për Pije*, IKSHP.

i derdh ujërat e ndotura në kanalizimet publike, dhe popullata urbane është ajo që kryesisht e gëzon komoditetin e lidhjes me sisteme të furnizimit me ujë.

Kjo nuk është befusuese kur marrim parasysh që ndërtimi i liqenjve të lartpërmendur është bërë njëkohësisht me zhvillimin infrastrukturor në qendrat e mëdha urbane në Kosovë. Në anën tjetër, qytetet e vogla, si Deçani, Istogu, dhe shumë të tjerë, edhe sot e kësaj dite nuk kanë kanalizim.³⁴

Megjithatë, një burim i tretë e shpjegon një situatë edhe më të mjerë. Sipas shkencëtares Korça, në vitin 2003 vetëm 44 përqind të popullatës ishin të lidhur me ujësjellësin publik. Në fakt, kjo shifër arrinte në 7 përqind në vendbanimet rurale, ku rreth 60 përqind të popullatës furnizoheshin me ujë nga pusët private apo nga ujësjellësit privat lokal. Statistikat e lidhjes me sistem adekuat të kanalizimit janë në fakt edhe më të këqija se ato të deklaruara nga dy burimet tjera. Korça shkruan që në vitin 2003, vetëm 28 përqind e popullatës ishin të lidhur me sistemin e kanalizimit. Në vendbanime rurale, kjo shifër ishte 3 përqind e ulët; atje popullata përdor gropa septike.³⁵

Kështu, më tepër se 60 përqind e popullatës së Kosovës që jeton në vise rurale i hedhin jashtëqitjet e tyre si ujëra të zeza në lumenjtë e vegjël dhe përrocka, i përdorin gropat septike, apo thjeshtë lejojnë që ujërat e zeza të futen në tokë.³⁶ Pusët e ujit dhe largimi i ujërave të zeza në Kosovë kontrollohen shumë pak, dhe kjo gjendje është edhe më e keqe në fshatrat e largëta. Përveç kësaj, burimet e ujit nuk kontrollohen dhe nuk kanë mirëmbajtje profesionale. Kjo paraqet rrezik serioz për shëndetin e popullatës në viset rurale.

Për shkak të dallimeve të qarta në statistikat e burimeve të ndryshme, mund ta nxjerrim vetëm një përfundim: akoma nuk ka mbikëqyrje koherente dhe të bashkërenduar të fakteve më të thjeshta lidhur me ujin. Kjo, megjithatë, nuk e ndryshon pamjen e përgjithshme: shumica e qytetarëve akoma nuk kanë qasje në furnizimin me ujë dhe në kanalizim adekuat.

OBSH-ja raportoi në vitin 2000 që “Kosova ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë në Evropë sa i përket sëmundjeve të bartura nëpërmjet ujit.”³⁷ Në vitet 1999 dhe 2000, banorët e viseve rurale, shumica prej të cilëve ishin të zhvendosur nga lufta, u goditën nga tularemia e bredhësve. Analiza e 46 shtëpive dhe e 76 shtëpive të kontrolluara tregoi që infektimi ishte bartur nëpërmjet ushqimit dhe ujit të kontaminuar dhe që bredhësit

³⁴ Biblioteka e Resurseve të IKS, Prishtinë 2004-2009.

³⁵ Cituar në: Prof. Bardha Korça, *Case study of Kosova, (in The implementation of the right to water and sanitation in Central and Eastern Europe)*, Strasbourg, Mars 2006.

³⁶ Cf. International Management Group: *Damage Assessment Sanitation-Final Report, 2000*, f. 14.

³⁷ Cituar në: *Case study of Kosova, (in The implementation of the right to water and sanitation in Central and Eastern Europe)*, Strasbourg, Mars 2006.

ishin burimi i infektimit. Përhapja e tularemisë solli në shprehje nevojën për hartimin e politikave për përmirësimin e burimeve të ujit për komunitetet dhe menaxhimin e mbeturinave në mbarë Kosovën.³⁸

Por gjendja nuk ka ndryshuar shumë. Sipas vlerësimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, sot rreth 70 deri 80 përqind të ujërave në rajonet rurale janë të ndotura me jashtëqitje.³⁹ Përveç kësaj, sasi e pamjaftueshme e klorit përdoret për dezinfektimin e ujit dhe asnjëri prej burimeve të ujit të pijshëm nuk janë të mbrojtur. Selvete Hoxha-Krasniqi, zëvendës drejtoreshë në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, thotë:

Më tepër se 200 sëmundje ngjitëse përhapen me anë të ujit të ndotur. Nuk kemi bazë të mirë të dhënave, por megjithatë mund të shohim se kemi shkallë të lartë të sëmundjeve ngjitëse... barkëqitja akute është shumë e shpeshtë dhe po shohim numër gjithnjë e më të madh të rasteve të hepatitit. Të gjitha këto sëmundje ndërlidhen me higjienë të pamjaftueshme, me ujë të ndotur, dhe me ndotje të mjedisit. Në këto raste, Instituti i thërret inspektorët sanitar, por nevojitet shumë punë për t'i bindur ata që të reagojnë.⁴⁰

Por pse duhet të brengosen Prishtinën për këtë problem? Në fakt, ata duhet të brengosen. Njëra prej arsyeve është që Kosova ende nuk ka një impiant të vetëm për trajtimin e ujërave të zeza. Ku derdhen rreth 50,000 tonelata të ujërave të zeza të Prishtinës çdo vit? Përgjigja e shkurtër është: në natyrë.

Në vitin 1950 ishin bërë përpjekje për ndërtimin e sistemit për trajtimin e ujërave të zeza në kryeqytet. Në atë kohë, lumi kryesor i Prishtinës, Vellusha, kishte filluar të përdorej si kanalizim i qytetit. Kur planifikuesit urban dështuan në vendosjen e kanalizimit adekuat për ujërat e zeza, ata vendosën në vend të kësaj ta mbulojnë lumin. Kështu, planet për ndërtimin e sistemit për trajtimin e ujërave të zeza në vitet e 50-ta kurrë nuk u ekzekutuan në tërësi.⁴¹ Kërcënimi i vërshimeve të vazhdueshme dhe kundërmimi i jashtëqitjeve e kishin bindur përfundimisht Kuvendin Komunal ta mbulojë edhe lumin e dytë të Prishtinës, Prishtevkën.

Më në fund, në vitin 1974 u ndërtua impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë. Mirëpo, ky sistem kurrë nuk u përdor në mënyrë adekuate dhe me kalimin e kohës u mbyll.⁴² Praktika e mbulimit të lumenjve në vend të adresimit adekuat të problemit ende vazhdon dhe kjo shihet më së miri në rastin e përrockës së vogël që derdhet nga parku i *Gërmisë* në qytet, dhe e cila është mbuluar gradualisht pasi që ndërtimet e reja kanë dërdhur mbeturina të shtëpive të reja në te. Që nga viti 1999, planifikimi i dobët i

³⁸ IKSHIP, ISHP North Rhine, OBSH et al. *Hulumtimi i Përhapjes së Tularemisë në Kosovë: Kontrolli i Rasteve dhe Studime Mjedisore*. Vol 8, No.1, Janar 2002.

³⁹ Intervista e IKS me Prof. Dr. Selvete Hoxha-Krasniqi, zëvendës drejtoreshë në IKSHIP, Prishtinë, Nëntor, 2008.

⁴⁰ *Ibid.*

⁴¹ IKS Punim Diskutimi, *Vizioni Utopik*, Përmbledhje e Materialit. Prishtinë, 2006.

⁴² Cf. International Management Group: *Damage Assessment Sanitation-Final Report*, 2000, f. 14.

infrastrukturës publike ka krijuar pengesa shtesë për sistemet e furnizimit me ujë dhe sistemet për largimin e mbeturinave.

Kështu, sistemet e kanalizimit të Prishtinës vazhdojnë ti derdhin ujërat e zeza direkt në lumenjtë e Prishtinës që vazhdojnë të derdhën në lumin Sitnica dhe në Ibër. Po, kjo i bën Prishtinalinjtë ndotësit më të mëdhenj të ujit në Kosovë. Në princip, ekonomitë familjare në viset rurale kanë ndikim të njejtë në gjendjen e mjedisit sa edhe ekonomitë familjare në qendrat urbane, vetëm se madhësia e Prishtinës e bën ndikimin e saj në mjedis më të madh. Gjendja e ujit bëhet alarmante nëse marrim parasysh që rreth 167,000 tonelata ujëra të zeza prodhohen në Kosovë në vit.⁴³ Siç e pamë edhe në rastin e lartpërmendur të Obiliqit, ujërat e zeza industriale nuk trajtohen dhe ato derdhen drejtpërdrejt në lumenjtë e vendit.⁴⁴

Në komunën e Prishtinës, numri i rritur i përdoruesve të rinj krijon barrë shtesë për sistemin aktual të furnizimit me ujë i cili edhe ashtu lëngon nga kapaciteti i pamjaftueshëm i ujit dhe nga humbjet e konsiderueshme të ujit nga rrjedhjet në sistem, stacionet e vjetra të trajtimit të ujit me kapacitet të kufizuar, dhe mungesa e planifikimit adekuat urban.⁴⁵ Komuna e Prishtinës furnizohet me ujë nga dy liqenj artificial, Batllava dhe Badovci, dhe uji nga këta dy liqenjë pastaj trajtohet kimikisht në dy impiante. Rrjeti i vjetër i distribuimit të ujit shpeshherë rrjedh paralel me gypat e kanalizimit dhe kjo paraqet rrezik për pastërtinë e ujit të pijshëm dhe për shëndetin e popullatës.

Përveç ujit, edhe mbeturinat solide dhe keqpërdorimi i tokës janë çështje problematike. Edhe pse rreth 90 përqind e popullsisë urbane në Kosovë gëzon shërbimin e largimit të mbeturinave, ky shërbim është në përgjithësi i dobët për shkak të mungesës së pajisjeve dhe vendeve për hedhjen e mbeturinave. Tarifat mujore për mbledhjen e mbeturinave janë rreth 3 euro për shtëpi, por shkalla e faturimit është e dobët, vetëm rreth 30 deri 40 përqind. Për dallim nga kjo, më pak se 10 përqind e zonave rurale kanë shërbim për mbledhjen e mbeturinave.⁴⁶

Prej korrikut të vitit 1999 deri në fund të vitit 2000 nuk ka pasur sisteme për largimin e mbeturinave solide. Vlerësimet e fundit tregojnë që prodhimi i mbeturinave është rreth dy kilogramë për kokë banori në ditë. Nga 29 deponi komunale në mbarë Kosovën, Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) dhe donatorët tjerë i kanë rehabilituar 26; janë rindërtuar dhe ndërtuar edhe nëntë deponi rajonale qendrore.⁴⁷ Këto vende janë nën përgjegjësinë e Ndërmarrjes Publike të Deponive.

⁴³ Firdezi Bekteshi, *Challenges Facing Kosova*, REC, Prishtina 2008.

⁴⁴ Forumi 2015, *Një Perall Moderne*, Prishtina, 2007, f. 40.

⁴⁵ OSCE Departamenti i Monitorimit, *Cështja e Furnizimit me Ujë në Kosovë*, Qeshor 2008.

⁴⁶ Firdezi Bekteshi, *Challenges Facing Kosova*, REC, Prishtinë, f. 37.

⁴⁷ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë, *Plani i Veprimtë për Mbrojtjen e Mjedisitë 2006-2010*, Prishtinë 2006, f. 33.

Ekzistimi i vendeve për deponim nuk garanton largimin adekuat të mbeturinave solide. Kosova nuk ka asnjë sistem për frenimin e substancave të rrezikshme. Lëndët toksike nga kanisterët dhe akumulatorët e makinave ende rrjedhin në tokë kudo që të hidhen. Mbeturinat e spitaleve, që mund të përmbajnë edhe sëmundje ngjitëse, hidhen së bashku me mbeturinat e tjera. Reciklimi pothuajse nuk ekziston fare.

Shpërdorimi i burimeve natyrore siç është toka është evidente edhe në zonat e mbrojtura me ligj siç është Parku Rajonal i Gërmisë, ku Qeveria e Kosovës filloi ndërtimin e Qendrës Protokolare Administrative në vitin 2005. Në përgjithësi, ka shumë pak zona të gjelbra, dhe parqet e Kosovës janë viktimizuar nga bumi ndërtimor i pasluftës. Kosova ka vetëm një park kombëtar, *Sharrin*, i shpallur i tillë në vitin 1986. Edhe pse është zonë e mbrojtur, nuk ka plan menaxhues dhe ende mbetet e paqartë se kush është përgjegjës për menaxhimin e parkut: Drejtoria e Parqeve në Prizren, Drejtoria e Parqeve në Shtërpce, apo Agjencioni për Pylltari. Në mungesë të mbikëqyrjes së qartë, parku i është nënshtruar shpyllëzimit, industrializimit nëpërmjet gurthyesve, ndërtimeve të paligjshme, dhe mirëmbajtjes së dobët të formave të ndryshme të mbeturinave të njerëzve.⁴⁸

Gjendja e mjedisit në Kosovë është qartazi katastrofike në të gjitha fushat, dhe ekzistojnë dëshmitë e ndikimit të ndotjes së ajrit në shëndetin e popullatës. Edhe eksponimi disavjeçar i nivelit të ulët ndaj përzierjes së ndotësve të ndryshëm në ujë, ajër, ushqim dhe në produkte të konsumimit, mund të ketë ndikim të ndjeshëm në gjendjen shëndetësore të qytetarëve. Vlerësohet se rreth 20 përqind e sëmundjeve në vendet industriale janë pasojë e faktorëve mjedisor. Nuk është fare çudi që politika mjedisore e BE-së që nga fillimi është mbështetur në aspektin shëndetësor.⁴⁹ Dëshmitë tregojnë që fëmijët dhe të moshuarit janë kategoritë më të ndjeshme ndaj rreziqeve mjedisore.

Çështjet aktuale të mjedisit në Kosovë duhet të trajtohen me urgjencë. Megjithatë, edhe nëse gjendja shëndetësore nuk shkakton brenga serioze, gjithmonë ekzistojnë arsytet politike dhe ekonomike për t'i trajtuar problemet mjedisore në Kosovë, siç kemi sugjeruar në seksionin me lart.

⁴⁸ Insituti i Mbrojtjes së Natyrës, *Gjendja e Natyrës 2006-2007*, AKMM, Prishtinë, f. 37.

⁴⁹ Strategjia Evropiane e Mjedisit dhe Shëndetit, Komunikat nga Komisioni për Këshill, 2007.

ATËHERË, NË ÇDO VEND ËSHTË BETEJË E VËRTETË

“Standardet e larta të mjedisit stimulojnë inovacione dhe mundësi të biznesit, në mënyrë që mos të ketë kontradiktë në mes mbrojtjes së mjedisit dhe mirëqenies sonë të vazhdueshme ekonomike.” – Broshura Mjedisore e DG-së

Kosova nuk është fare e vetmuar në sfidat e saj mjedisore; ajo nuk është as e para e as e fundit që po ballafaqohet me këto sfida. Derisa Evropa Perëndimore i ka përjetuar bekimet e industrializimit dhe urbanizimit shumë më herët se pjesët e tjera të Evropës, ajo poashtu i ka përjetuar edhe mallkimet e këtyre dy proceseve. Shkatërrimi i mjedisit, ndotja e dheut, pyjeve, ajrit dhe ujit; dhe dëmtimi i mjedisve imediate të njeriut në qendrat e atëhershme urbane me zhvillim të shpejtë në Angli, Gjermani dhe Francë, shtruan nevojën për veprimet e para për mbrojtjen e mjedisit. Vjena ishte qyteti i parë në Evropë i cili në mënyrë të suksesshme u lidh me furnizim me ujë të freskët dhe kanalizim të ujërave të zeza në mesin e viteve të 1700-ta. Ndërtimi i kanalizimit publik në Londër filloi tek në vitin 1842, dhe Frankfurt am Main, në Gjermani, ishte qyteti i parë në Evropë që i pastroi ujërat e zeza në vitin 1882.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin vendi i parë që kuptuan që çështjet mjedisore ngërthejnë jo vetëm mjediset imediate të njeriut. I ballafaquar me zhdukjen e pëllumbit udhëtar dhe me rënien e shpejtë të bizonëve, Presidenti Woodrow Wilson themeloi Shërbimin e Parkut Kombëtar në vitin 1916. Ideja e mbrojtjes së natyrës dhe e specieve të saj si detyrë e moralit njerëzor për herë të parë u artikulua në mënyrë koherente në *A Sand County Almanac* nga Aldo Leopold në vitin 1949.⁵⁰

Në vitin 1962, biologja amerikane Rachel Carson botoi librin *Silent Spring (Pranvera e Heshtur)*, ku argumentonte që pesticidet mund ta shkaktojnë kancerin dhe që rritja e shkujdesur e sektorit të bujqësisë do ta shkatërronte botën e kafshëve të egra nëse nuk ndalohen toksinet si DDT-ja (diklorodifenitrikloroetani), njeri prej pesticideve më të njohura sintetike.⁵¹ Në vitin 1970 u formua Agjencioni Amerikan për Mbrojtje të Mjedisit dhe ky ndaloi DDT-në në SHBA. Pastaj në vitin 1971 u formua *Greenpeace* në Vankuver të Kanadasë, në shenjë proteste kundër testeve nukleare të SH.B.A-ve në Alaskë. Një vit më vonë, më 1972, Klubi i Romës botoi raportin shokues *The Limits of Growth (Kufinj të Rritjes)*, i cili në mënyrë eksplicite nënvizonte faktin që burimet natyrore të botës kishin fund dhe që kohës së njerëzimit në tokë mund t'i vinte fundi.⁵²

Atëbotë, lindi ideja e rritjes së qëndrueshme. Në vitin 1979, astroshkencëtari James Lovelock shkroi punimin *Gaia Hypothesis* dhe kërkoi që Toka duhet të kuptohet si NJË

⁵⁰ Aldo Leopold, *A Sand Country Almanac*, Oxford University Press, Oxford 1949.

⁵¹ Rachel Carson, *Silent Spring*, Boston, 1962 (appeared first in three chapters in New Yorker).

⁵² Donella H. Meadows et al, *The limits of Growth*. A report to the Club of Rome, 1972.

organizëm. Fotografia e Planetit Tokë e bërë nga hapësira kozmike, mermeri i kaltër, u bë ikonë e ambientalistëve në mbarë botën.⁵³

Që atëherë, në botë ka pasur shpërthim të aktiviteteve, fushatave për mjedisin, dhe ndikimeve për zhvillim të politikave. Ka pasur shumë përpjekje, mirëpo sukseset kanë qenë më të pakta. Beteja për ndalimin e asbestosit si material ndërtimor, sepse është dëshmuar që shkakton kancerin në mushkëri, ka filluar në fillim të viteve të 1940-ta dhe akoma nuk është fituar. Ndalimi i aerosolit; lufta kundër substancave kimike siç është dioksini; fushatat kundër zhdukjes së balenave, panterëve dhe gorilave; përpjekjet për t'i dhënë fund mbipeshkimit në oqeanë, vdekjes së lumenjëve më të mëdhenj të Evropës, si dhe shkatërrimit të pyjeve të pashkelura, janë beteja ende të përfunduara. Është dashur të kalojnë dekada të tëra që të dëgjohet zëri dhe brengat e shkencëtarëve dhe qytetarëve të rëndomtë.

Fatkeqësisht, faktori më bindës që ka ndikuar në ndryshimet e politikave kanë qenë katastrofat e mëdha që dëmtuan mijëra njerëz. Pas fatkeqësisë së tmerrshme në Soveso të Italisë në vitin 1976 dhe në Bhopal të Indisë në vitin 1984, u ndërmorrën masat e para konkrete për rregullimin dhe uljen e përdorimit të dioksinut. Në vitin 1985, Gjermania themeloi Ministrinë e parë Federale për Mjedis, Mbrojtje të Natyrës, dhe për Sigurinë e Reaktorëve Bërthamor, vetëm pas shpërthimit të reaktorit termonuklear disa mijëra kilometra më larg në Chernobyl të Ukrainës. Sot, ministritë e këtylla janë të rëndomta në mbarë Evropën. Në vitin 2000, Austria i bashkoi të gjitha funksionet vitale në Ministrinë për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Menaxhim të Ujërave, duke i vënë nofkën “Ministria e Jetës”.⁵⁴

Në Samitin e BE-së në Paris në korrik të vitit 1972 u njoh që, në kontekstin e zgjerimit ekonomik dhe përmirësimit të cilësisë së jetës, duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme mjedisit. Rrjedhimisht, u miratua Programi i Parë i Veprimit për Mjedisin, që mbulonte periudhën 1973-1976. Kjo pastaj u shoqërua me programe tjera shumëvjeçare të llojit të njëjtë, të cilat çuan në miratimin e një seti direktivash. Akti i Vetëm Evropian në vitin 1987 i shtoi Traktatit të Romës që në mënyrë specifike trajtonin këtë temë (nenet 130r-130t) dhe njihet si pika e kthimit për mjedisin. Traktati poashtu përhapi idenë që “Kërkesat për mbrojtjen e mjedisit do të jenë pjesë përbërëse e politikave tjera të Komunitetit.”⁵⁵

Hyrja në fuqi e Traktatit në Bashkimin Evropian në nëntor të vitit 1993 solli progres të ri në disa fronte. Traktati e shtoi konceptin e “rritjes së qëndrueshme dhe joinflacioniste e cila e respekton mjedisin” në detyrat e Komunitetit Evropian dhe e shkroi principin paraprak në nenin për mjedisin. Ai poashtu e ngrii “veprimin e ndërlidhur për mjedisin”

⁵³ James Lovelock, *Gaia: a New Look at Life on Earth*, Oxford 1979.

⁵⁴ Shih www.lebensministerium.at.

⁵⁵ Shih Broshura Mjedisore e DG-së,8.

në statusin e “politikës” me të drejtë vetanake.⁵⁶ Në vitin 1994, në Kopenhagen, u themelua Agjencioni Evropian i Mjedisit.⁵⁷ Kështu, mbrojtja e mjedisit për Komunitetin Evropian më nuk është set i “veprimeve,” por “politikë” koherente. Në vitin 1999, Traktati i Amsterdimit e shndërroi politikën e mjedisit në synim të rëndësishëm politik të Bashkimit Evropian. Aktualisht, Komisioni Evropian po punon në zbatimin e EAP-it të gjashtë, i cili e mbulon periudhën 2002-2012.⁵⁸ Katër prioritetet kyçe janë ndryshimet klimatike, natyra dhe biodiversiteti; shëndeti dhe cilësia e jetës; burimet natyrore; dhe mbeturinat.

Konventa e Aarhusit e vitit 1998 synon të forcoj rolin e qytetarëve dhe organizatave mjedisore duke e përkrahur të drejtën e tyre për transparencë dhe llogaridhënie të shteteve nënshkruese. Në termet praktik, banorët lokal duhet të përfshihen në çështjet që ndikojnë në mjedisin e tyre siç janë rrugët e reja, termocentralet, apo pajisjet për djegien e mbeturinave. Anëtarët e publikut poashtu kanë të drejtë ta dinë gjendjen e mjedisit të tyre dhe në disa rrethana ta padisin qeverinë apo ndotësit që përpiqen t’i fshehin katastrofat mjedisore. Konventa hyri në fuqi në tetor të vitit 2001.⁵⁹

Kushti për anëtarësim në BE është që vendet kandidate duhet t’i harmonizojnë sistemet e tyre ligjore me legjislacionin e BE-së në të gjitha fushat, të ashtuquajturin *Acquis Communautaire*. Procesi i integritit të ligjeve të BE-së në sistemet kombëtare ligjore administrative quhet procesi i përafrimit. *Acquis* është koleksion i dokumenteve që definojnë principet themelore të BE-së, të cilat çdo anëtar i ri duhet t’i pranoj dhe t’i shndërroj në politika praktike para se t’i bashkangjitet BE-së. Aktualisht, *acquis* ka 35 kapituj, të cilat duhet të nënshkruhen veç e veç derisa Vendi Anëtar potencial kalon nëpër fazat e ndryshme të kandidimit.

Kërkesat për mjedisin përshkruhen në mënyrë të hollësishme në Kapitullin 27, i njohur si njeri prej kapitujve më të ndërlikuar, pas bujqësisë dhe lëvizjes së lirë të mallrave. Për të hyrë në BE, Kosova duhet ta kompletoj procesin dhe të punoj në zbatimin e tij. Kapitulli 27 përfshin më tepër se 200 akte ligjore, rregullore, direktiva, vendime dhe rekomandime, në mes të cilave janë: legjislacioni horizontal, cilësia e ajrit dhe ndryshimet klimatike, menaxhimi i mbeturinave, menaxhimi i ujërave, mbrojtja e natyrës, kontrolli i ndotjes industriale, kemikali, zhurma, organizmat e modifikuar gjenetiksht, pylltaria, dhe mbrojtja civile.⁶⁰

⁵⁶ *Ibid.*

⁵⁷ Shih <http://www.eea.europa.eu/> dhe http://ec.europa.eu/dgs/environment/pdf/information_brochure_en.pdf.

⁵⁸ Programi i Gjashtë i Veprimit të Ambientit nga Bashkimi Evropian 2002-2012.

⁵⁹ Shih webfaqen e UNECE në: <http://www.unece.org/env/pp/welcome.html>.

⁶⁰ BE *Acquis Communautaire*: Kapitulli 27, Mjedisit (Për negociatën me Turqinë dhe Kroacin, *acquis* është ndarë në 35 kapituj, me qëllim të balancimit më të mirë të kapitujve: duke i ndarë kapitujt më të vështirë në kapituj të veçantë për negociim më të lehtë, duke i bashkuar disa kapituj më të lehtë dhe duke i lëvizur disa politika nëpër kapituj, si dhe duke i riemëruar disa gjatë procesit).

Kapitulli për mjedisin bazohet edhe në veprimin parandalues apo në principin “ndotësi paguan,”⁶¹ duke e luftuar ndotjen e mjedisit në thelbin e saj, në përgjegjësinë e përbashkët, dhe në integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së. Është me rëndësi të theksohet që përmbushja e *acquis* kërkon investim të jashtëzakonshëm. Për aplikimin e *acquis* kërkohet një administratë e fuqishme dhe e pajisur mirë në nivelin qendror dhe lokal.

Kapitulli 27 i *acquis* në mënyrë të qartë thotë që “së paku një autoritet në nivelin kombëtar duhet të marr përgjegjësi për zbatimin e ligjit të KE-së në fushën e mjedisit.” Aty poashtu thuhet që “një ‘autoritet kompetent’ kombëtar kërkohet edhe në shtetet federale, edhe kur pjesa më e madhe e legjislacionit është miratuar dhe zbatuar në nivelin e qeverisë rajonale.”⁶²

Legjislacioni i BE-së për mjedisin dhe direktivat e tij të ndryshme bëjnë thirrje për themelimin e autoriteteve kompetente. Ky legjislacion poashtu përcakton shumë përgjegjësi për autoritetet lokale. Konventa e Aarhusit për Qasjen në Informata, Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi për Çështje të Mjedisit, e vitit 1998, në mënyrë specifike thotë që mbrojtja e mjedisit nuk është vetëm çështje kombëtare. Ajo kërkon edhe përfshirje dhe llogaridhënie nga niveli komunal.⁶³

KU GJENDEMI NE?

Atëherë kush e mban timonin dhe çfarë progresi është arritur deri sot në zbatimin e legjislacionit aktual, duke e vendosur Kosovën në rrugën e drejtë për anëtarësim në BE? Ndoshta edhe më e rëndësishme për qytetarin e rëndomtë është pyetja: çka po bën Qeveria e Kosovës për adresimin e degradimit të lartëpërmendur të mjedisit dhe për përmirësimin e gjendjes së mjerë shëndetësore?

Statusi aktual i pasigurt i Kosovës në raport me Bashkimin Evropian nënkupton që Kosova është vend i hutuar dhe shtet kandidat potencial.⁶⁴ Kjo megjithatë nuk do të thotë që autoritetet qendrore dhe komunale mund të relaksohen dhe të mos punojnë në mënyrë proaktive në përmbushjen e kushteve të *acquis communautaire* që janë në përgjegjësinë e tyre. Sa më gjatë që presin autoritetet për të ndërmarrë veprime, aq më të mëdha do të bëhen problemet mjedisore të Kosovës. Përveç arsyeve politike për veprim, ka edhe brenga urgjente shëndetësore të cilat janë elaboruar më lartë.

⁶¹ Sipas këtij principi, në shumë vende Evropiane ndërtesat, industritë, kompanit dhe bizneset duhet të pagujnë në shum të caktuar para ndërtimit dhe/ose para se të hapin biznesin. Pastaj ato vizitohen nga inspektorët për tu vërtetuar nëse biznesi/kompania në fjalë i ka respektuar normat për mbrojtjen e mjedisit.

⁶² Kapitulli 27 i BE *acquis communautaire*.

⁶³ Konventa e Aarhus, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën, 1998.

⁶⁴ Deri sot, 22 nga 27 vende të BE e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Deri më sot, Qeveria e Kosovës ka qenë e zellshme dhe ka dëshmuar hap të shpejtë në miratimin e disa ligjeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Siç shihet në Tabelën 1.1, legjislacioni për mjedisin i miratuar që nga viti 2003 përfshin ligjet për Mbrojtjen e Mjedisit, Mbrojtjen e Ajrit, Ujit, Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Gjyëtinë, Mbeturinat, Aktivitetet Hidrometeorologjike, Mbrojtjen e Natyrës, Mbrojtjen e Bimëve, Mbrojtjen kundër Fatkeqësive Natyrore dhe fatkeqësive tjera, Mbrojtjen kundër Zhurmës, Vlerësimi Strategjik i Mjedisit, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, dhe Parandalimi dhe Kontrolli i Ndotjes së Integruar.

Tabela 1.1 Harmonizimi i Ligjeve të Kosovës me Acquis Communautaire

Harmonizimi me Acquis	Year	Statusi
Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit	2003 (2009)	Miratuar
Ligji për Mbrojtjen e Ajrit	2004	Miratuar
Ligji për Ujin	2004	Miratuar
Ligji për Transportin e Mallrave të Rrezikshme	2004	Miratuar
Ligji për Gjyëtinë	2005	Miratuar
Ligji për Mbeturinat	2006	Miratuar
Ligji për Aktivitetet Hidrometeorologjike	2006	Miratuar
Ligji për Mbrojtjen e Natyrës	2006	Miratuar
Ligji për Mbrojtjen e Bimëve	2007	Miratuar
Ligji për Mbrojtjen kundër Fatkeqësive Natyrore dhe fatkeqësive tjera	2007	Miratuar
Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma	2008	Miratuar
Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit	2009	Miratuar
Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	2009	Miratuar
Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes së Integruar	2009	Miratuar

Pavarësisht nga miratimi i disa ligjeve që ndërlidhen me mjedisin dhe *acquis*, Kosova ende nuk e ka arritur stadin e duhur. Kosova, për shembull, nuk ka standarde kombëtare për ujë të pijshëm, por i përdor standardet e BE-së dhe OBSH-së si udhërrëfyes.⁶⁵ Ligji për Ujin thotë që të gjithë personat kanë të drejtë të barabartë dhe proporcionale për

⁶⁵ Sabine Hoffman, "Implementation of the Right to Water and Sanitation in Central and Eastern Europe," Case Study of Kosova by Bardha Korça.

përdorimin e ujit dhe që publiku duhet të ketë qasje në të gjitha informatat për burimet e ujit, për vendimet për menaxhimin e ujërave si dhe të marrin pjesë në këto vendime.⁶⁶ Strategjia Kombëtare për Mjedisin poashtu siguron “të drejtën e të gjithë qytetarëve për ujë të pijshëm.” Megjithatë, as Ligji e as Strategjia nuk përcaktojnë se si do të arrihet “barazia për përdorimin e ujit” dhe “e drejta për ujë të pijshëm.” Përveç kësaj, në Kosovë nuk ekziston asnjë trup monitorues për të vlerësuar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtës për ujë dhe pastërti.⁶⁷ Kosova nuk ka as strategji të ujit, meqë ajo është në fazë të hartimit. Shihet qartë që përveç ligjeve, instrumenti primar ligjor është nënligji,⁶⁸ i cili shpeshherë mungon në Kosovë.

Mund të thuhet që mbrojtja e mjedisit në Kosovë është relativisht mirë e rregulluar në *letër*. Poashtu është arritur progres drejt harmonizimit të legjislacionit ekzistues me atë të BE-së. Në terren, megjithatë, gjërat duken ndryshe; mbetet akoma shumë për t’u bërë në fazën e zbatimit.

Historia institucionale e mbrojtjes së mjedisit në Kosovën daton që nga viti 1974 kur u themelua Instituti për Mbrojtjen e Natyrës. Instituti ishte përgjegjës për “përkujdesjen dhe përmirësimin e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit” dhe “organizimin e mirëmbajtjes së zonave të mbrojtura të natyrës.”⁶⁹ Që nga viti 1992, Ministria Jugosllave e Shkencës, Zhvillimit dhe Mjedisit ishte përgjegjëse për çështjet e mjedisit në Kosovë.⁷⁰ Mirëpo, gjatë atyre viteve nuk i është kushtuar vëmendje gjendjes së përkeqësuar mjedisore në Kosovë.

Kosova ka shumë pak për të raportuar sa i përket historisë së lëvizjes së gjelbër në vitet e 90-ta. Pas abrogimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1991, aktivisti politik Daut Maloku themeloi Partinë e Gjelbër të parë në Kosovë. Që atëherë, Maloku është kryetar i partisë. Partia e Gjelbër ka fituar më pak se 0.2 përqind të votave në zgjedhjet e para në vitin 2000. Prandaj, ajo nuk morri pjesë në zgjedhjet e vitit 2004 dhe 2007.

Pas konfliktit të vitit 1999 dhe pas vendosjes së strukturave të UNMIK-ut, gjërat filluan të lëvizin me shpejtësinë e breshkës. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/32 për Themelimin e Departamentit Administrativ për Mbrojtje të Mjedisit vendosi bazën ligjore për krijimin e Departamentit të UNMIK-ut për Mbrojtje të Mjedisit (DEP). Ky i fundit morri përgjegjësitë për aktivitetet e ndërlidhura me mbrojtjen e ujit, ajrit, tokës dhe biodiversitetit. DEP ishte poashtu përgjegjës për zbatimin e strategjive dhe rregulloreve.⁷¹ Me krijimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) më 13 shtator 2001, DEP u shkri në Ministrinë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor (MMPH).

⁶⁶ Ligji i Ujit, Nr. i Ligjit 2004/24 Neni. 5(h); PISG, 2004.

⁶⁷ Bibloteka e Resurseve të IKS.

⁶⁸ REC *Progress in Environmental Law Drafting in South Eastern Europe*, December 2005, f. 139.

⁶⁹ Ligji i Institutit për Mbrojtjen e Natyrës: Strategjia e Mjedisit për Kosovën, 2004.

⁷⁰ REC *Progress in Environmental Law Drafting in South Eastern Europe*, December 2005, f. 132.

⁷¹ *Ibid.*, f. 132.

Ministria morri përsipër portfolion e Departamentit për Banim dhe Ndërtim, DEP-it, dhe Departamentit për Menaxhimin e Ujërave.⁷² Në këtë Ministri, mbrojtja e mjedisit është vetëm njëri prej shtatë departamenteve.⁷³

Legjislacioni bazik me të cilin mund të vepronte Ministria hyri në fuqi tek në vitin 2003 pas miratimit të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit, i cili synon “të hartoj kornizë bazike ligjore që do të promovoj mjedis gjithnjë e më tepër të shëndetshëm për popullin e Kosovës me anë të zbatimit gradual të Standardeve Mjedisore të Bashkimit Evropian.”⁷⁴ Sipas këtij Ligji, përgjegjësitë kryesore të Ministrisë janë: “Hartimi i politikave dhe strategjive relevante në sektorin e ajrit, ujit dhe mbeturinave, planifikimi i zhvillimit të infrastrukturës mjedisore, dhe përgatitja e normave dhe standardeve dhe lëshimi i direktivave.”⁷⁵

Aftësia e MMPH-së për zbatimin e përgjegjësiave të saj për mbrojtjen e mjedisit u dëmtua pjesërisht nga mungesa e buxhetit të mjaftueshëm. Qeveria e Kosovës i akordoi MMPH-së vetëm 1.07 përqind nga Buxheti i Kosovës në vitin 2009. Përqindja prej 1.12 përqind e akorduar në vitin 2008 në fakt përbënte financim më të ulët për shkak të shumës më të vogël të Buxhetit të Kosovës.⁷⁶ Në buxhetin e vitit 2009 mund të shihen përmirësime modeste. (shih Tabelën 1.2).

Megjithatë, MMPH-ja nuk ishte e fundit në listën e financimit; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, funksionet e së cilës poashtu ndërliidhen me mbrojtjen e mjedisit, përfitoi më së paku fonde.

⁷² *Ibid.*, f.132

⁷³ Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit, Departamenti i Planifikimit Hapsinor, Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit, Departamenti i Ujit, Departamenti i Administratës Qendrore, Departamenti i Prokurimit, Departamenti i Menaxhimit të Parqeve. Shih <http://www.ks-gov.net/mmp>.

⁷⁴ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr.03/L-025; Republika e Kosovës, 2009.

⁷⁵ Ligji i Mbrojtjes së Mjedisit, Ligji Nr.03/L-25; Neni 5.

⁷⁶ Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Republika e Kosovës, pasqyret buxhetore për 2008 dhe 2009

Tabela 1.2 Ministritë me Buxhetet më të Mjerueshme në vitet 2008 dhe 2009

Ministria	2008		2009	
	BK (në Euro)	Përqindja e BK-së	BK (në Euro)	Përqindja e BK-së
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	8,684,931	0.80	12,161,791	1,069
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	12,245,898	1.12	12,253,696	1,070
Ministria e Shëndetësisë	57,891,404	5.30	66,282,033	5,830
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	157,657,495	14.45	159,931,028	14,070

DEP-i i dikurshëm dhe MMPH-ja aktuale ka 13 inspektorë përgjegjës për tërë Kosovën. Ata janë aktiv në të gjitha fushat e përgjegjësisë në Ministri, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e mjedisit.⁷⁷ Nga viti 2003 deri në vitin 2009, këta 13 inspektorë kanë dërguar vetëm 120 gjoba në gjyq, prej të cilave janë zgjidhur vetëm tri.⁷⁸ Për shkak të gjendjes së qartë të mjedisit të përshkruar më lartë, nuk mund të flitet për “sundimin e ligjit.” Pa sundim të ligjit, individët dhe ndërmarrjet mund të vazhdojnë ta ndotin mjedisin pa pasur frikë nga pasojat e mundshme. Derisa inspektorët shprehin keqardhje që nuk është bërë më tepër në këtë drejtim, në të njëjtën kohë është e qartë që kontrolli i shtrenguar nuk është prioritet i ministrisë apo qeverisë.

Fakti që MMPH-ja ka mungesë të ndjeshme të stafit është vetëm filli i problemeve të saj. Zyrtarët e ministrisë vazhdimisht ankohen për mungesën e alokimeve buxhetore dhe ekspertizës njerëzore, për bashkëpunimin e pamjaftueshëm ndërministror dhe për shkallën minimale të vetëdijësimit publik.⁷⁹

Argumenti që mjetet buxhetore janë shumë të pakta për zbatimin e politikës më të gjerë për mbrojtjen e mjedisit mund të vihet në dyshim. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit i vitit 2003 parasheh themelimin e Eko Fondit, i cili do të ndihmojë në lehtësimin e kufizimeve financiare me anë të mbledhjes së tarifave, taksave dhe donacioneve për mbrojtje të mjedisit.⁸⁰ Fondi fillimisht do të menaxhohej nga MMPH dhe më vonë do të shndërrohej në trup të pavarur. Megjithatë, fondi akoma nuk është formuar. Përç kësaj, Ministria duhet të hartoj një ligj i cili rregullon kompetencat, administrimin, burimet financiare,

⁷⁷ Intervist e IKS me zyrtarë të MMPH, Prishtinë, Maj, 2009.

⁷⁸ Intervist e IKS me Vehbi Ejupin, MMPH, Inspektor i Mjedisit, Janar, 2009.

⁷⁹ *Ibid.*

⁸⁰ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, (2003) 2009, Neni 77.

dhe mjetet për mbrojtje të mjedisit nga Eko Fondi. Statusi politik i Kosovës e ka penguar themelimin e fondeve të pavarur.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit poashtu parasheh themelimin e Bordit Mbikëqyrës për Mbrojtje të Mjedisit.⁸¹ As ky Bord akoma nuk është formuar. Ministri thotë që Kuvendi i Kosovës po punon në këtë drejtim.⁸²

Plani Veprimor për Mjedis i Kosovës 2006-2010 merr parasysh shumë probleme mjedisore, mirëpo vetëm pesë nga 52 prioritetet e Planit janë në proces të zbatimit.⁸³ Sa i përket monitorimit të mjedisit, Kapitulli V i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit identifikon tri trupa përgjegjës: Ministrinë, “subjektet ligjore apo të natyrshme të cilat me veprimet apo aktivitetet e tyre mund ta ndotin mjedisin,” dhe komunat.⁸⁴ Qartazi, procedurat standarde për raportimin e tyre të obligueshëm akoma duhet të vendosen, ndërkohë që bashkërendimi i tyre në monitorimin e degradimit mjedisor është përplotë me paqartësi.

Së pari, Ministria është e obliguar ta themeloj një sistem të plotë të monitorimit për të gjitha fushat e mjedisit.⁸⁵ Në pajtim me këtë përgjegjësi, nga viti 2006 deri në vitin 2009, Ministria themeloi një bazë të të dhënave e cila duhet të përfshij të gjitha burimet e informimit në shpejtësi të kohës reale. Për ta bërë këtë, baza e të dhënave duhet të lidhet me Sistemin e Informimit Gjeografik me stacionet monitoruese në mbarë Kosovën. Problemi është që këto stacione fare nuk ekzistojnë, dhe planet e Ministrisë për blerjen e stacioneve të reja lëvizëse të matjës akoma duhet të zbatohen. Prandaj, baza e të dhënave mbetet e zbrazët. Për ta zgjidhur këtë çështje, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit i vitit 2003 parasheh themelimin e agjencionit mjedisor për bashkërendimin e mbledhjes së të dhënave.

Që nga viti 2007, Agjencioni Kosovar për Mbrojtje të Mjedisit (AKMM) ka qenë përgjegjës për detyrat administrative, profesionale dhe shkencore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në zonat e mbrojtura të natyrës dhe në biodiversitet.⁸⁶ Institucioni gjendet në Dardani dhe ka rreth 30 punëtorë. Edhe pse drejtori është emëruar në vitin 2006, vet institucioni nuk kishte funksionuar deri në korrik të vitit 2007.⁸⁷ AKMM nuk varet plotësisht nga fondet që transferohen nga MMPH-ja. Themelimin e AKMM-së e kanë ndihmuar edhe organizatat ndërkombëtare.

Si institucion qeveritar, AKMM është përgjegjëse për monitorimin e mjedisit, ndërtimin e sistemeve efikase për mbledhjen e informatave, dhe për raportimin e vazhdueshëm mbi

⁸¹ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 62.

⁸² Intervistë e IKS-it me Ministrin Mahir Yagcilar, Prishtinë, Maj 2009.

⁸³ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit të Kosovës, 2008.

⁸⁴ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 50.1 – 50.3.

⁸⁵ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 50.

⁸⁶ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 60.

⁸⁷ See: http://ëëë.ks-gov.net/akmm/english/about_us/about_us.htm.

gjendjen e mjedisit për ta ruajtur cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit. AKMM është e obliguar të promovoj burime të energjisë së ripërtëritshme dhe rezistencën ndaj keqpërdorimit të burimeve të natyrës.⁸⁸ Për t'i zbatuar këto përgjegjësi, AKMM duhet të themeloj sistem efikas të informimit duke drejtuar dhe bashkërenduar punën e institucioneve të ndryshme, shumica e të cilave janë shumë më të vjetra se AKMM-ja. Kjo ka rezultuar me mosmarrëveshje të mëdha institucionale, të cilat pastaj ndikuan në cilësinë, sasinë dhe shpejtësinë e mbledhjes dhe shpërndarjes së informatave.

Një institucion të cilin e mbikëqyr AKMM është i lartpërmenduri Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK). IHMK është pjesërisht përgjegjës dhe i pajisur për matjen e ndotjes së ujit, ajrit dhe rreshjeve të shiut.⁸⁹ Instituti ka 16 punëtorë dhe gjendet jashtë Prishtinës në rrugën drejt Fushë Kosovës, në ndërtesën e njejtë që 30 vite. IHMK ka një pikë të vetme të matjes jashtë Prishtinës dhe me përkrahjen e OBSH-së ka ndërtuar edhe 12 pika stabile për matjen e ajrit në Mitrovicë, por asnjera prej tyre nuk është e lidhur me bazën e të dhënave GIS. Si rezultat i kësaj, MMPH-ja nuk ka të dhëna sistematike për cilësinë e ajrit në Prishtinë dhe posaçërisht në Obiliq.

Një institucion tjetër i cili duhet t'i raportoj AKMM-së është Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit në Kosovë (IMNMK) i formuar në vitin 1974 dhe i cili u bashkua me AKMM-në vitin 2007. Sipas drejtorit të AKMM-së, Instituti megjithatë ekziston vetëm formalisht.⁹⁰ Statusi i ardhshëm i Institutit dhe funksionimi i tij mbeten të paqarta, edhe pse Instituti kishte botuar Raportin mbi Gjendjen e Natyrës në vitin 2008. Ka edhe institucione tjera që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për punën e AKMM-së, por që nuk janë nën mbikëqyrjen e tij të drejtpërdrejt.

Për shembull, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës, i cili gjendet në kompleksin e Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë, është burim poashtu i rëndësishëm i informimit. Instituti zhvillon të gjitha llojet e analizave dhe strategjive laboratorike që ndërlidhen me ekologjinë dhe mjedisin, në shkallën ku këto informata janë të aplikueshme për vlerësimet e rrezikut mbi shëndetin. Instituti është poashtu përgjegjës për kontrollin e ujit të pijshëm në mbarë Kosovën. Që nga dhjetori i vitit 2008, IKSHP ka dy stacione mobile për matjen e ndotjes së ajrit në Prishtinë.⁹¹ Aktualisht, ky është institucioni i vetëm që bën matjen sistematike të cilësisë së ajrit (përfshirë këtu edhe NO₂) në Prishtinë. Mirëpo, IKSHP i përgjigjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe jo MMPH-së. Nëse shkëmbimi i informatave institucionale do të përmirësohej me anë të udhëzimeve të qarta procedurale, stacionet matëse të IKSHP-së mund të ndihmojnë në mbushjen e disa zbrazëtive në bazën e të dhënave GIS të MMPH-së.

⁸⁸ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 60.1.14.

⁸⁹ Ligji për Aktivitetet e Institutit Hidro-Meteorologjik, (Ligji Nr. 02/L-79), Neni 5.4.

⁹⁰ Intervistë e IKS-it me Ilir Moina, Drejtor i AKMM-së, Prishtinë, Dhjetor 2008.

⁹¹ Intervistë e IKS-it me Prof.Dr. Selvete Hoxha-Krasniqi, Zëvendës-Drejtoreshë e IKSHP-së, Prishtinë, Nëntorë 2008.

Një institut tjetër i cili nuk është nën AKMM-në dhe i cili bën matje të rregullta të ndotjes së ajrit, bën pjesë në kategorinë e dytë të “subjekteve ligjore apo të natyrshme” që janë përgjegjëse për monitorimin e mjedisit në pajtim me Ligjin. Instituti INKOS dhe laboratorët e tij gjenden në Obiliq. Kjo nuk është befásuese meqë vet KEK-u e kishte themeluar INKOS-in në fund të viteve të 1960-ta. Instituti ofron një mori shërbimesh shkencore, nga gjeologjia dhe teknologjia e deri te mjedisi. Si “Institut i Kosovës,” ai u shndërrua në ndërmarrje private me aksione të nëpunësve gjatë procesit të privatizimit në periudhën e pasluftës. Me kërkesë INKOS-i vazhdon të bëjë matjen e emetimit të ndotësve në ajër, por i raporton vetëm KEK-ut dhe KEPA-së. Mirëpo, në kundërshtim me Nenin 50.5 të Ligjit, INKOS-i nuk i ndan të dhënat e tij me publikun.⁹² Sipas Drejtorit të INKOS-it, KEK-u shumë rrallë i kalon standardet e lejuara evropiane gjatë stinës së dimrit.⁹³ Por a duhet t’i besojnë qytetarët të Kosovës INKOS-it i cili i qëndron besnik vetëm KEK-ut?

Është e qartë që monitorimi dhe raportimi mbi cilësinë e ajrit në Kosovë mbetet i mjegulltë.⁹⁴ Duke marrë parasysh numrin e akterëve të përfshirë, si mund MMPH-ja nëpërmjet AKMM-së të fitoj një pasqyrë të qartë të ndotjes së ajrit në Kosovë? Me anë të legjislacionit sekondar, urgjentisht duhet të sqarohen përgjegjësitë e sakta të institucioneve të ndryshme dhe të procedurave të tyre raportuese në mënyrë që AKMM-ja të jetë në gjendje t’i ofroj publikut të dhëna të kohës reale për ndotësit e ajrit, jo vetëm në Prishtinë dhe Obiliq, por në mbarë Kosovën.

Nuk është befasi se probleme të ngjashme me monitorim dhe raportim ekzistojnë edhe në rastin e çështjeve të tjera mjedisore. Ka shumë pak informata për cilësinë e tokës.⁹⁵ Kjo përgjegjësi duhet të jetë në duart e Ministrisë së Bujqësisë dhe e institucioneve të saj pasuese, mirëpo për shkak të shkallës së ulët të komunikimit dhe bashkërendimit në mes të ministrive, kjo akoma duhet të qartësohet. IHMK ka pranuar haptazi që atyre ju mungojnë të dhënat për cilësinë e ujërave nëntokësor në Kosovë,⁹⁶ dhe që Divizioni për Menaxhimin e Mbeturinave në MMPH nuk lexon në mënyrë sistematike të dhënat për prodhimin, mbledhjen, trajtimin, përpunimin dhe largimin e mbeturinave.

Drejt monitorimit të “subjekteve ligjore apo të natyrshme të cilat me veprimet apo aktivitetet e tyre mund ta ndotin mjedisin,” MMPH është poashtu përgjegjëse për ofrimin e Vlerësimeve mbi Ndikimin në Mjedis, të cilat ofrojnë shënime të hollësishme për ndikimin në mjedis të çdo projekti të propozuar. Ligji i ri për Vlerësimin e Ndikimit në

⁹² Intervistë e IKS me Beqir Xhema, Drejtor i INKOS-it, Nëntorë 2008.

⁹³ Intervistë e IKS me Beqir Xhema, Drejtor i INKOS-it, Nëntorë 2008.

⁹⁴ Situata në përgjithësi u përmbledh nga Raporti i Progresit të KE 2008: “Nuk ka matje sistematike të kualitetit të ajrit sepse legjislacioni është ende i pamjaftueshëm dhe Kosva ende nuk ka rrjet të monitorimit të kualitetit të ajrit” (Raporti i Progresit të Kosovës, Komisioni Evropian, 2008).

⁹⁵ Vetëm dy raporte të njohura kanë informacione minimale: AKMM, “Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007,” Prishtinë: AKMM, 2008 dhe “Raporti i Gjendjes së Mjedisit 1999-2003,” Prishtinë: AKMM, 2004.

⁹⁶ Intervistë e IKS me Sylë Tahirsylaj, Drejtor i IHMK-së, Tetorë 2008.

Mjedis është miratuar.⁹⁷ Sipas Ligjit, çdo ndërmarrje që operon në Kosovë duhet ta kalojë VNM-në, madje edhe *qebaptoret* e thjeshta.⁹⁸ Pas VNM-së, mund të aplikohet “principi paraprak i pagesës për ndotje” për ta parandaluar, kufizuar apo për të kërkuar llogari strikte ose mbulim të sigurimit nga një projekt i cili ka gjasa ta dëmtoj mjedisin. Ligji është akoma shumë i ri dhe Ministria rishtazi ka filluar të njihet me këtë Ligj, prandaj zbatimi i tij ende nuk ka filluar.⁹⁹

Është shumë e mundur që kjo fushë e re e aktiviteteve do të ndeshet me praktikat aktuale të komunave. Për shembull, Komuna e Prishtinës tashmë ka një rregullore që cakton tarifën për ndotje të ambientit. Tarifën në përgjithësi janë mjaft të larta, prej €2,500 deri në €10,000 për “ndotje ekonomike,” varësisht nëse bëhet fjalë për një person apo subjekt.¹⁰⁰ Fatkeqësisht, gjuha e rregullore është mjaft e paqartë dhe duket se askush nuk është gjobitur deri sot.

Duhet poashtu të thuhet që këtë rregullore nuk e kanë të gjitha komunat. Qartazi, komuna e Obiliqit, ku është i vendosur mega-ndotësi i Kosovës KEK-u, nuk e ka këtë rregullore. Është tejet e rëndësishme që Qeveria e Kosovës menjëherë të vendosë norma të qarta të emetimit në nivelin kombëtar. Pa legjislacionin e nevojshëm sekondar, “aktet e veçanta” që qartësojnë kufijtë e emetimit dhe imitimit, KEK-u dhe ndotësit e tjerë mund të vazhdojnë ta ndotin Kosovën lirshëm dhe pa kurfarrë frike nga detyrimet financiare. Përveç kësaj, nëse nuk vendosen kufijtë nuk mund të matet as shkalla e dëmit të shkaktuar.

Këtu qëndron detyra e dytë esenciale dhe urgjente për Qeverinë: vendosja dhe zbatimi i menjëhershëm i procedurave të qarta në nivelin qendror për dënimin e ndotësve drejt zbatimit të principit “ndotësi paguan.”

Në fund, nevojiten bashkërendimi dhe bashkëpunimi i përmirësuar në mes institucioneve të ndryshme, në bazë të përgjegjësi të përbashkëta më të qarta dhe procedurave të hollësishme për monitorim dhe raportim mbi gjendjen e mjedisit.

NGATËRRIMI I KOMPETENCAVE

Siç përmendëm më lartë, *acquis communautaire* i Bashkimit Evropian vë theks të veçantë në rolin e komunave të cilat shihen si trupa të qeverisë së decentralizuar me funksione rregulluese dhe të bazuara në shërbime. Komunat janë përgjegjëse për ndërtimin e

⁹⁷ Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, (Ligji N. 03/L-024), Republika E Kosovës, 2009, Neni 2 dhe 4.

⁹⁸ Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, (Ligji N. 03/L-024), Republika E Kosovës, 2009, Neni 6.

⁹⁹ Intervistë e IKS me zyrtarë të MMPH, Prishtinë, Maj 2009.

¹⁰⁰ Komuna e Prishtinës, Rregulloret Komunale, Rregulloret për Mbrojtjen e Mjedisit, Prishtinë, 2006. Neni 27.

kapacitetit bazik lokal për inspektim, zbatim, monitorim dhe kontroll të mjedisit. Ligji për Vetëqeverisje Lokale cakton kushtet vijuese për komunat:

- i) Komunat do të ketë kompetenca të plota dhe ekskluzive... në fushat... e mbrojtjes lokale të mjedisit... dhe ato ndërmarrin rregullimet dhe veprimet e tjera sipas nevojës.¹⁰¹

Kompetencat e komunave në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të shoqëruara me Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit (2009) iu japin komunave përgjegjësi shtesë në pajtim me *acquis communitaire*: kontrol dhe mbikëqyrje të drejtpërdrejt mbi institucionet administrative, personat, organizatat joqeveritare, organizatat profesionale, dhe ndërmarrjet. Përveç kësaj, komunat poashtu gëzojnë autoritetin për hartimin e instrumenteve planifikuese për mbrojtjen e mjedisit përbrenda komunës dhe për vendosjen e masave të arsyeshme lokale për mbrojtjen e natyrës në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik sipas legjislacionit primar dhe sekondar.¹⁰²

Komunat poashtu mund të miratojnë masa komunale për mbrojtjen e mjedisit në pajtim me ligjin dhe legjislacionin sekondar.¹⁰³ Komunat duhet t'i raportojnë MMHP-së për zbatimin e planeve të tyre komunale për mjedisin. Mirëpo, deri sot vetëm pesë komuna kanë nënshkruar planet veprimore për mjedisin.¹⁰⁴ Prishtina, për shembull, nuk ka plan të veprimit; ekziston vetëm një draft njëfaqësh se si komuna planifikon ta festoj Ditën e Tokës dhe Ditën e Ujit. Në përgjithësi, deri më sot vetëm disa komuna janë përqendruar në vendosjen e standardeve në pajtim me Ligjin për Ofruesit Komunal të Shërbimeve dhe planet lokale të veprimit mjedisor.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, komuna është poashtu përgjegjëse për lëshimin e licencave mjedisore.¹⁰⁵ Mirëpo, as Ligji i ri i vitit 2009 nuk specifikon ndonjë procedurë por vetëm thotë që “Mbikëqyrja inspektive për Licencat Komunale Mjedisore do të bëhet nga ana e inspektorëve të mjedisit.”

Komuna e Prishtinës deri në vitin 2008 nuk e hapi zyrën në Drejtori, dhe nuk kishte ndarë buxhet për të. Deri në janar të vitit 2009 nuk ishte emëruar asnjë zyrtar përgjegjës për mjedisin, dhe Drejtorja kishte dy inspektorë të patrajnuar të mjedisit për tërë komunën. Si rezultat, në vitin 2008 në qytetin e Prishtinës ishin dorëzuar vetëm pesë raporte. Përgjegjësia kryesore e inspektorëve komunal është t'i adresojnë ankesat të cilat qytetarët i dorëzojnë me shkrim apo me anë të telefonit. Inspektorët duhet t'i hetojnë të gjitha ankesat dhe të hartojnë një “raport të gjendjes” ku ofrojnë shënime të hollësishme për veprimet e nevojshme nga ana e komunës apo ta mbyllin rastin. Ata poashtu mund t'i

¹⁰¹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr. 03/L-40: Republika e Kosovës, 2008, Neni 17.1.

¹⁰² Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 24.

¹⁰³ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 7.3.

¹⁰⁴ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2008.

¹⁰⁵ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 32.

përcjellin ankesat tek “agjencionet tjera përgjegjëse” siç është policia apo Ndërmarrja e Ujit.

Numër shumë i vogël i komunave kanë më tepër se dy apo tre zyrtarë që punojnë në sektorin e mjedisit. Disa komuna, siç është Obiliqi, nuk kanë fare inspektorë të mjedisit. “Kemi rekomanduar së paku gjashtë anëtarë të stafit për çdo komunë,” thotë Tush Markaj, ekspert lokal i angazhuar nga OJQ “EPTISTA” i cili punon me komunën në çështje të mjedisit. “Inspektorët aktual janë të pakualifikuar dhe punojnë me buxhet shumë të ulët,” shtoi ai.¹⁰⁶

Buxheti për mjedisin është me të vërtetë një problem tjetër i rëndësishëm, dhe niveli qendror qartazi nuk ka ofruar shembull të mirë në alokimet e tij buxhetore për sektorin e mjedisit. Prishtina e ka administratën më të madhe komunale, me rreth 649 anëtarë të stafit¹⁰⁷ dhe buxhet vjetor prej më tepër se €42 milion në vitin 2009,¹⁰⁸ që është më i madh se buxhetet e Pejës dhe Prizrenit bashkë. Megjithatë, komuna e Prishtinës nuk ka pasur buxhet për mjedisin deri në vitin 2009, edhe atëherë ky buxhet ishte vetëm €250,000.

Bashkërendimi në mes MMPH-së dhe Komunës së Prishtinës mbetet i paqartë. Ndërmarrja lokale për mbledhjen e mbeturinave *Pastrimi* (ish-Higjiëna Teknika) është shembull i mirë i kësaj. Në letër, mbledhja e mbeturinave është përgjegjësi e komunës. Në sytë e publikut, komuna mban fajin nëse në qytet ka mbeturina. Në fakt, *Higjiëna Teknika* u themelua në vitin 1957 si ndërmarrje publike nën menaxhim të komunës. Mirëpo, në vitin 2002, ndërmarrja kaloi nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. *Higjiëna Teknike* në vitet e ardhshme u bashkua me ndërmarrjet e tjera për mbledhjen e mbeturinave nga komunat fqinje, dhe morri emrin e ri *Pastrimi*. Tash një ndërmarrje e ndarë nga qeveria i menaxhon deponitë.

Sa i përket mbeturinave dhe ujit, ekziston një ngatërrim i ngjashëm në mes të kompetencave të MMPH-së, komunave, dhe Zyrës Rregullative të Ujit dhe Mbeturinave (ZRUM), posaçërisht në nivelin komunal. ZRUM ishte njëri prej bordeve këshilluese i formuar për të ofruar mbikëqyrje të procesit të menaxhimit. Përgjegjësitë e tij ishin garantimi i standardeve të larta të shërbimit, caktimi i tarifave, dhe zgjidhja e ankesave të konsumatorëve.

Për këto sisteme nuk funksionojnë. Mungesa e kontejnerëve për mbledhjen e mbeturinave i kontribuon edhe më tepër hedhurinave ilegale, derisa ndërmarrja private refuzon të

¹⁰⁶ Intervistë e IKS me Tush Markaj, Ekspert lokal për mjedis “EPTISTA”, Prishtinë, Janar, 2009.

¹⁰⁷ Komunitat kanë burime të qëndrueshme të të hyrave: ato marrin gjashtë grante të ndryshme qeveritare si dhe mund të gjenerojnë të hyra vetanake. Buxheti komunal është i miratuar për një vit fiskal që fillon me 1 Janar: Granti për Administratën Komunale, Granti për Arsim, Granti për Shëndetësi, Granti për Njësinë e Zjarrfikësve, Grantet LCO+LCR.

¹⁰⁸ www.peishtina-komuna.org.

vendos kontejnerë të rinj për shkak të numrit tejet të vogël të konsumatorëve që paguajnë për këtë shërbim. Katërdhjet e pesë përqind e faturave të ekonomive familjare nuk paguhen, dhe është vështirë të shkëputen familjet individuale nga shërbimet e ofruara pa ndikuar në të njejtën kohë në tërë lagjen.

Një shembull tjetër i ngatërrimit të kompetencave mund të gjindet në komunën e Obiliqit, e cila është e shkatërruar në aspektin mjedisor. Qyteti i Obiliqit ka vetëm një zyrtar për mbrojtje të mjedisit, nuk ka asnjë inspektor të mjedisit, nuk ka pajisje për monitorim dhe nuk ka strategji për mbrojtjen e mjedisit. Edhe pse komunat janë përgjegjëse për matjen e ndotjes së ajrit dhe ujit, në Obiliq, instituti i lartpërmendur INKOS e ka marrë përsipër këtë detyrë. Ndërmarrja private nuk shkëmben informata me zyrtarët komunal.¹⁰⁹ Në mënyrë që komuna t'i kryej këto detyra ajo duhet të ketë buxhet më të madh për ti mbledhur masat adekuate si dhe më tepër ekspertizë lokale.¹¹⁰

Ironikisht, edhe pse gjindet mu afër KEK-ut, reduktimet e energjisë elektrike kanë ndikuar në punën e zyrtarit mjedisor, si dhe në punën e nëpunësve të tjerë qeveritar. Mbase komunat shpeshherë gabojnë duke menduar se mbrojtja e mjedisit nënkupton vetëm mirëmbajtjen e rrugëve dhe sipërfaqeve të gjelbra dhe kjo shpjegon faktin që Komuna e Obiliqit ka alokuar vetëm €6,500 nga buxheti i saj vjetor për mjedisin në vitin 2008.¹¹¹

Obiliqi nuk gëzon autoritet për mbrojtjen e mjedisit dhe për trajtimin e çështjes së ndotjes që vjen nga KEK-u. Është e qartë që mekanizmat zbatues janë pothuajse inekzistent dhe që kapacitetet për trajtimin e sfidave ekzistuese mjedisore janë tejet të ulëta. Z. Nijazi Shala, zyrtari komunal në krye të mbrojtjes së mjedisit, thotë që “KEK-u është ndotësi më i madh në Kosovë.” Kjo deklaratë megjithatë nuk është ndonjë ndriçim i mendjes. Meqë KEK-u është prodhuesi i vetëm i energjisë elektrike në Kosovë, e tërë Ministria e Energjisë është e përkushtuar ta hartoj dhe kontrolloj këtë fushë të politikës nga kryeqyteti i Prishtinës. Prandaj, në nivelin komunal nuk mund të bëhet asgjë për ta ndaluar ndotjen që vjen nga KEK-u. Është poashtu e qartë që shumica e problemeve mjedisore në komunat e Obiliqit dhe Prishtinës janë përtej aftësive dhe autoritetit të këtyre komunave. Përveç kësaj, çështjet si energjia elektrike dhe zhvillimi ekonomik shpeshherë kanë përparësi mbi brengat për mjedisin. “Ekonomia” është në mesin e fjalëve të para në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit; neni i parë thotë, “Kosova do ta harmonizoj zhvillimin ekonomik me principet themelore për mbrojtje të mjedisit sipas konceptit për zhvillim të

¹⁰⁹ Intervistë e IKS me Nijazi Shala, Zyrtar për Mjedis në Komunë të Obiliqit, Tetor 2008.

¹¹⁰ Sipas Z. Shala mbështetja e vetme që ne kemi pasur ishin trajnimet dhe konsultimet, të tilla si njëra që ai aktualisht kishte marrë pjesë të organizuar nga REC dhe organizata “Eprista”. Edhe pse këto trajnime ndihmojnë nuk janë të mjaftueshme për të përballuar krizat mjedisore,” tha ai veçanërisht pasi që ai punon i vetem në zyre në të cilën ka ndërprerje të shumtë të energjisë elektrike.

¹¹¹ Intervistë e IKS me Nijazi Shala, Zyrtar për Mjedis në Komunë të Obiliqit, Mars 2009.

qëndrueshëm.” Kjo mund të interpretohet që autoritetet nuk duhet të ndërmarrin hapa për mbrojtjen e mjedisit nëse kjo mund ta pengoj potencialisht progresin ekonomik.¹¹²

MJEDISI I KOSOVËS: BRENGË LUKSOZE?

Varfëria në Kosovë është e përhapur gjithandej. Afro 15 përqind të popullatë rreth 2 milionëshe jeton nën kufirin e varfërisë. Gjysma prej tyre janë nën moshën 24 vjeçare, dhe rreth 47 përqind janë të papunë, numër ky që është dukshëm më i madh në krahasim me vendet fqinje.¹¹³ Në vitin 2004, GDP-ja e Kosovës për kokë banori vlerësohej të ishte €1,230, në mesin e kuotave më të ulëta në Evropën Qendrore dhe Juglindore.¹¹⁴ Prandaj, zhvillimi ekonomik me çdo kusht është prioriteti i parë i qeverisë.

Kosova, si vend i ri, po kalon nëpër periudhë të vështirë të tranzicionit. Zhvillimi industrial ende shihet si shenjë e progresit, derisa mjedisi konsiderohet brengë luksoze të cilën një vend në zhvillim e sipër thjeshtë nuk mund t’ja lejoj vetës. “Më kujtohet fotoja e termocentralit Kosova A në kalendarin e vitit 1980 me pesë tymtarët dhe tymin e rëndë që dilte prej tyre; atëbotë, ishte tregim i bukur i progresit dhe suksesit,” thotë z. Simnica, deputet i PDK-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe punëtorë me përvojë 30-vjeçare në KEK. “Fatkeqësisht, tregimi nuk ka ndryshuar shumë. Sot, ne përsëri i shikojmë tymtarët, dhe tymi është gjëja e vetme që e shohim. Dhe brenga jonë e vetme është a kemi rrymë.”¹¹⁵

Përveç kësaj, Memorandumi Ekonomik i Kosovës (MEK) i vitit 2004, e identifikoi sektorin e energjisë dhe minierave si burim potencial të rritjes ekonomike.¹¹⁶ Bazuar në zbulimin e statusit të burimeve të energjisë, Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit,¹¹⁷ përkundër potencialit të saj të ulët me ujë.¹¹⁸ Industria do të mund të përparonte krahas tregut në rritje të energjisë elektrike në rajon, dhe investitorët nga sektori privat do të futeshin për ta zgjeruar gjenerimin e rrymës elektrike dhe bizneseve të mihjes kryesisht për qëllime të eksportit.¹¹⁹ Plani për ndërtimin e termocentralit të ri *Kosova e Re* me qymyr të linjtit, në afërsi të termocentralit ekzistues dhe në një zonë të dendur me banorë, do të ndikoj mbi rreth 700,000 njerëz,¹²⁰ por Banka Botërore e ka identifikuar ndërtimin e termocentralit të ri si përmirësim të rëndësishëm ekonomik.

¹¹² Definicioni “zhvillim i qëndrueshëm” (28) është shumë i paqartë; në versionin Anglisht duket të tregojnë se nuk duhet pasur kujdes për gjenerata e ardhshme edhe pse ky mund të jetë një gabim në përkthim. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2009, Neni 1.

¹¹³ World Bank Poverty Assessment Report, Maj 2008.

¹¹⁴ World Bank Poverty Assessment Report, 2004.

¹¹⁵ Intervistë e IKS me Sabri Simnica, Obiliq, Tetorë 2008.

¹¹⁶ World Bank, Kosovo Economic Memorandum, Maj 2004, f. 43.

¹¹⁷ MMPH, “Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007,” f. 31.

¹¹⁸ World Bank, Kosovo Economic Memorandum, Maj 2004, fq. 43

¹¹⁹ Kosovo Economic Memorandum, World Bank, Maj 2004.

¹²⁰ Kosova Qendrore është me 80 përqind të objekteve industriale në tërë vendin.

Prandaj, forca kryesore lëvizëse prapa politikës aktuale mjedisore në Kosovë duket të jetë më tepër e përqendruar në përmbushjen e standardeve të BE-së për anëtarësimin e ardhshëm të Kosovës sesa në përkushtimin e mirëfilltë të qeverisë për mbrojtje të mjedisit.¹²¹ Këtë e dëshmon edhe përqendrimi në kornizën ligjore me fare pak vëmendje ndaj zbatimit dhe buxhetit të mjaftueshëm që i është alokuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Problemet mjedisore akoma nuk shihen si prioritet dhe mbesin pjesë e agjendës kombëtare politike vetëm si rezultat i presionit të jashtëm dhe i integritit në BE. “Mjedisi nuk do të jetë prioritet derisa të mos përmirësohet gjendja ekonomike. “Si mund ta kemi mjedisin prioritet kur jemi shtet i varfër?” pyet Ilir Morina, drejtor i AKMM-së. Ai përfundon, “Ekonomia dhe ekologjia nuk shkojnë njera me tjetrën. Sikur ekologjia të ishte prioriteti ynë, do të na duhej ta mbyllim KEK-un menjëherë.”¹²²

Propozimi për termocentralin e ri ndezi njërin prej debateve të para mjedisore në mediat kryesore në Kosovë. Plani i ri i qeverisë për ndërtimin e termocentralit të ri, Kosova C, e ndau publikun në dysh. Megjithatë, qëndrimet pro dhe kundër ndërtimit të një termocentrali kaq të madh u përqendruan më tepër në madhësinë e impiantit dhe në çështjet e ndërlidhura ekonomike. Në vend se të përqendrohej në atë nëse projekti ishte pozitiv nga aspekti mjedisor, qeveria nganjëherë e zhvendoste debatin në zgjidhjen e thjeshtë në mes energjisë dhe prosperitetit ekonomik dhe ngecjes prapa në rrugën drejt modernizimit.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit i jep qeverisë çdo të drejtë t’i injoroj brengat mjedisore në kontekst të zhvillimit ekonomik. Aty thuhet që ata duhet të jenë “të kujdesëshëm që zbatimi i standardeve dhe krijimi i një mjedisi të atillë duhet të bëhet në një mënyrë e cila është në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe me aftësinë e Kosovës ta përballoj koston e ndërlidhur (theksi i shtuar).”¹²³ Kjo mund të çoj në konkludimin që mjedisi nuk do të konsiderohet si prioritet derisa gjendja të bëhet katastrofike apo derisa Kosova të arrij prosperitet ekonomik.

¹²¹ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 1.

¹²² Intervistë e IKS me Ilir Morina, Drejtor i AKMM, Pishtinë, Janar 2009.

¹²³ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji Nr. 03/L-025; Republika e Kosovës, 2009, Neni 1.

KOSOVA E PASTËR: RRUGA PËRPARA

Në një proces me hap të shpejtë dhe gjysmë - neglizhent, Qeveria e Kosovës ka shpejtuar në hartimin e disa ligjeve që lidhen me mjedisin në Kosovë, e gjitha kjo si parakusht për hyrje në Bashkimin Evropian. Procesi në përgjithësi ka qenë i nxituar dhe nuk i është kushtuar vëmendje adekuate sigurimit të legjislacionit sekondar i cili është i nevojshëm për zbatimin e këtyre ligjeve. Zbatimi i përgjithshëm i legjislacionit ekzistues është pothuajse inekzistent. Nuk është shënuar fare progres në fushat e ndotjes industriale dhe menaxhimit të rreziqeve, në standardet për cilësinë e ajrit, apo për mbrojtjen e natyrës. Sa i përket monitorimit dhe raportimit, të dhënat mbasin të shpërndara gjithandej, institucionet nuk kanë fonde të mjaftueshme, dhe e gjithë kjo shoqërohet me ngatërrim të kompetencave.

Edhe komunat vuajnë nga çështjet e ngjashme, ato ballafaqohen me një mori sfidash të cilat e kufizojnë rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit. Komunat vuajnë nga mungesa e obligimeve dhe procedurave të qarta, mungesa e planeve veprimore apo strategjive mjedisore që adresojnë prioritetet mjedisore të komunave, financimi joadekuat, burimet e pamjaftueshme njerëzore, pajisjet e pamjaftueshme për monitorim, dhe mungesa e informatave për gjendjen e mjedisit të cilat pastaj duhet të barten tek qytetarët. Mekanizmat për zbatimin e legjislacionit në nivelin komunal pothuajse nuk ekzistojnë fare. Ngatërrimi i kompetencave në mes autoriteteve komunale dhe qendrore mbetet pengesë kyçe për zbatimin e legjislacionit për mjedisin.

Mungesa e legjislacionit të hollësishëm sekondar i shoqëruar me zbatimin e dobët të ligjit i kontribuon ndotjes së vazhdueshme nga ana e individëve dhe ndërmarrjeve që nuk frikohen nga pasojat eventuale. Edhe rastet më të thjeshta mjedisore kanë qenë vështirë të ndiqen penalisht në Kosovë. Njëra prej mënyrave për tejkalimin e kësaj gjendje është të forcohet lidhja në mes gjyqësorit dhe inspektoratit dhe të dëshmohet kapaciteti për zbatimin e legjislacionit për mjedisin. Një mënyrë tjetër është punësimi i personelit më të kualifikuar dhe më të përkushtuar, posaçërisht në pozitat e inspektorëve mjedisor. Por ç'është më e rëndësishmja duhet të vendosen kufijë të qartë të emetimeve në mënyrë që ndotësit të bartin përgjegjësi ligjore dhe financiare.

Vetëm paramendoni nëse çdo ndërmarrje që hedh pajisje dhe mbeturina shtesë në parqet dhe zonat e gjelbra të Prishtinës do të duhej të paguante një tarifë të caktuar? Paramendoni nëse KEK-u do të duhej t'i pastronte malet e hirit? Paramendoni nëse ndërmarrjet që po i shkatërrojnë malet dhe lumenjtë e Kosovës për përfitime financiare do të duheshin t'i kthejnë ato në gjendjen e mëhershme? Paramendoni nëse fqinjët tonë dhe pastruesit e makinave do të duheshin të paguajnë dënime për harxhimin e ujit të paktë dhe të çmueshëm për pije?

Sikur të mblidheshin dënime nga të gjithë këta ndotës në mënyrë strikte, sistematike dhe të rregullt, atëherë Eko Fondi do të kishte fonde mëse të mjaftueshme për MMPH-në si dhe për përpjekjet e ardhshme për mbrojtjen e mjedisit.

Qeveria e Kosovës nuk duhet të pres për rritjen e buxhetit të MMPH-së derisa të mblidhen këto fonde. Qeveria duhet të veproj menjëherë dhe t'i alokoj fonde të mjaftueshme MMPH-së në mënyrë që kjo e fundit t'i zbatoj përgjegjësitë e saj ligjore.

Tani nevojiten sisteme efektive, procedura të hollësishme, dhe përgjegjësi më të qarta për të monitoruar dhe rregulluar mjedisin, përfshirë këtu edhe bashkërendimin dhe bashkëpunimin e përmirësuar në mes të institucioneve të ndryshme. Përveç kësaj, me anë të botimit rregullt të hulumtimeve, AKMM mund t'i edukoj qytetarët për çështjet e mjedisit si dhe të mobilizoj përkrahje për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Por kjo listë e gjatë e detyrave nuk duhet t'i hidhet në duar vetëm qeverisë qendrore dhe qeverive komunale. Është koha e fundit të testohen muskujt e qytetarëve të Kosovës dhe të shoqërisë civile. Ne si Kosovarë a jemi në gjendje dhe të gatshëm të luftojmë për mbrojtjen e burimeve të Kosovës dhe për shëndetin e popullit tonë? A jemi të gatshëm t'ua bëjmë me dije udhëheqësve tanë të zgjedhur që mjedisi është *prioritet* për ne?

Rastet e njerëzve si Gëzimja, Jonuzi, Hajdari, Ruzhdiu dhe Igballja, si dhe vet gjendja përreth nesh, dëshmon që mbrojtja e mjedisit tashmë është shndërruar në një problem të ndjeshëm social. A duhet të qëndrojmë anash në mënyrë pasive dhe të heshtim derisa disa njerëz rreth nesh vdesin nga kanceri, derisa fëmijët pijnë ujë të ndotur në shkolla, derisa fenolet e helmueshme dëpërtojnë thellë në ujin dhe tokën tonë duke e kontaminuar ushqimin tonë, dhe derisa sëmundjet e kanaleve të frymëmarrjes përhapen rreth nesh?

Ne jemi të vetdijshëm që nuk mund të zgjidhen të gjitha problemet brenda ditës. Prandaj, i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës të shpall një kornizë të qartë kohore dhe hartë rrugore për dy çështje esenciale dhe emergjente: *të drejtën për ajër të pastër* dhe *të drejtën për ujë të pastër*.

Nëse institucionet shtetërore nuk e kontrollojnë ujin e pijshëm në Kosovë dhe nëse nuk ka strategji koherente për adresimin e problemit të ndotjes së ajrit në Kosovë, atëherë një numër i konsiderueshëm i Kosovarëve do të vazhdojnë të lëngojnë nga sëmundjet të cilat përndryshe janë të parandalueshme.

Këto dy detyra themelore duhet të na shërbejnë si udhërrëfyesi i parë në rrugën e drejtë e "Të Mendosh Gjellbër," si dhe të na shpiejnë më afër garantimit të kujdesit të nejtë për ushqimin, tokën, pyjet tona, dhe specieve të tjera në vendin tonë.

PËR NE

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është *think-tank* i pavarur dhe joprofitabil i cili përqëndrohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. E themeluar në vitin 2004, IKS ofron hulumtime inovative dhe politika relevante me synim që të nxis debate për çështjet e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Ne besojmë që debatet publike të bazuara në dëshmi janë thelbi i vendimmarrjes demokratike.

Që nga vera e vitit 2004, IKS ka zgjeruar stafin dhe sot përfshin gjashtë analistë dhe hulumtues me orar të plotë, dhe rrjet në rritje e sipër të hulumtuesve dhe bashkëpunëtorëve. IKS përkrahet në punën e saj nga Bordi Këshillues i përbërë nga analistë dhe praktikantë Kosovarë dhe ndërkombëtarë.

Që nga zanafilla e saj, puna IKS është përqendruar në çështjet e qeverisjes, zhvillimit ekonomik, planifikimit urban, korrupsionit në rindërtimin e pas-luftës, arsimit, problemit të imazhit të Kosovës si dhe strukturat qeverisëse ngatërruese të tanishme. IKS është poashtu pjesë e rrjetit të *think-tanks* në mbarë Evropën Juglindore të inspiruar nga ESI.

Të gjitha raportet tona mund ti gjeni në uebfaqen tonë.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet — IKS

Tel: + 381 38 222 321

E-mail: info@iksweb.org

www.iksweb.org

Adresa:

Rr. Garibaldi H11/6, Prishtinë, Kosovë

Kjo analizë e politikave është botuar në letër të ricikluar
dhe me ngjyrë të ricikluar të shtypit.

Mendoni Gjëlber!